

# Publikationen

zur rechtlichen Zusammenarbeit

botuar nga  
Enti për përfaqësim te Republikës së  
Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ  
dhe  
Fondacioni gjerman per bashkepunim  
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e  
regjistruar (IRZ)



Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut  
Botimi 1/2022, vëllimi i 11-të, viti i 8-të

Aktuelle Rechtsprechung des EGMR  
Newsletter 1/2022, 11.Band, 8.Jahrgang



Република Северна Македонија  
Министерство за правда



## BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2022

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo dhe Blerina Starova Zlatku

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, Drejtor i Fushës së Projektit për Europën Juglindore I (Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbi), dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RMV-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe:

Dr. Arnd Wöhler dhe Sonya Zayneb Ouertani – Menaxherë te Lartë e Projektit pranë IRZ-së

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i tij u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga  
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
para GJEDNJ-së

dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar  
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 1/ 2022, vëllimi i 11-të, viti i 8-të, në gjuhën shqipe



Newsletter zur Rechtsprechung des  
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von der Regierungsvertreterin von  
Nordmazedonien vor dem EGMR

und der  
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche  
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 1/2022, 11. Band, 8. Jahrgang in albanischer Sprache

*Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leserinnen und Leser,*

Sie halten eine neue Ausgabe des bereits im siebten Jahr erscheinenden Newsletters zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in den Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richterinnen und Richtern, Staatsanwältinnen und -anwälten sowie Behördenmitarbeiterinnen und –mitarbeitern in Nordmazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Nordmazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Nordmazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der Regierungsvertreterin von Nordmazedonien und Direktorin des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtsstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V., der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., und der Ost-Ausschuss – Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e.V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen wie die Bayer AG sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Nordmazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig. Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch

*Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashura lexuese dhe lexues,*

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të tetë të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatoreve de operatori të drejtësisë, veçanërisht gjyqtareve dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe prokurorëve dhe punonjëseve dhe punonjësve/ve të organeve administrative në Maqedoninë e Veriut.

Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë së Veriut ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë e Veriut janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve

Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterinnen), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.),

Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher

eine institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz (BMJ) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristinnen und Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen.

Der vorliegende Newsletter wird auch in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikationen-in-mazedonischer-sprache-публикации-на-македонски-јазик> und die albanische unter <https://www.irz.de/index.php/downloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Nordmazedoniens vor dem EGMR unter <http://biroescp.gov.mk> in der Rubrik „Sudska praksa“ (Praktika gjyqësore, Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle anderen Urteile des EGMR gegen Nordmazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigsten Rechtsprechungen des EGMR sind deshalb mithilfe dieses Newsletters allen Richterinnen und Richtern sowie Staatsanwältinnen und – anwälten in Nordmazedonien zeitnah direkt auf ihren eigenen Schreibtischen zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet.

Banken e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V.), Shoqata e Markave,

Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Komisioni i Lindjes – Shoqata e Europës Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Ost-Ausschuss – Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e.V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Bayer AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoninë e Veriut IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministria Federale e Drejtësisë (MFD).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislacionit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike.

Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së tek adresa <http://biroescp.gov.mk> në rubrikën „Sudska praksa” (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë së Veriut të përkthyer në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe në praktikë.



Deshalb gilt Frau Botschafterin Anke Holstein und ihren Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Bundesministerium der Justiz (BMJ), dass die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht.

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzerinnen und Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeiterinnen und Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Das sind bei der IRZ Frau Sonya Zayneb Ouertani und Frau Rita Linderoth, die diese Publikation in Bonn als Projektmanagerin und Senior Projektmanagerin betreut haben und Frau Nata-scha Andreevska-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Leserinnen und Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe dieser Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im Dezember 2021

**Danica Djonova LL.M**  
*Kommissarische Direktorin des Büros  
für die Vertretung Nordmazedoniens  
vor dem EGMR*

**Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner**  
*Leiter des Projektbereichs Südosteuropa I  
(Bosnien und Herzegowina, Montenegro,  
Nordmazedonien und Serbien)*

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlini plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zonjës Ambasadore Anke Holstein dhe kolegeve dhe kolegëve të sai me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe

Ministria Federale e Drejtësisë (MFD), e cila ka mundësuar punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve dhe përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura.

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegeve dhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij buletini. Këto janë në IRZ-ë Dr. Arnd Wöhler dhe Zj Zayneb Ouertani, të cilat janë kujdesur për këtë botim në Bon si Menaxherë të Lartë Projekti, Zj Natascha Andreevska- Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ- në bashkërendimin me partnerin e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexueset dhe lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, dhjetor 2022

**Danica Djonova LL.M.**

*Drejtoare e Komanduar e Agjencisë  
për përfaqësimin e Maqedoninë e Veriut  
para GJEDNJ-së*

**Avokat Dr. Stefan Pürner**

*Drejtor i Fushës së Projektit  
për Europën Juglindore I  
(Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi,  
Maqedonia e Veriut dhe Serbi)*

## Përmbajtja

Parathënia e botuesve ..... 4

### I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

**Behar dhe Gutman kundër Bullgarisë –**  
[29335/13](#), Vendimi 16.2.2021 [Seksioni IV] ..... 12

**Ribcheva dhe të Tjerë kundër Bullgarisë –**  
[37801/16](#), [39549/16](#) dhe [40658/16](#),  
Vendimi 30.3.2021 [Seksioni IV] ..... 17

**F.O. kundër Kroacisë –**  
[29555/13](#), Vendimi 22.4.2021 [Seksioni I] ..... 21

**Polat kundër Austrisë –**  
[12886/16](#), Vendimi 20.7.2021 [Seksioni IV] ..... 27

**Gumenyk dhe të Tjerë kundër Ukrainës –**  
[11423/19](#), Vendimi 22.7.2021 [Seksioni V] ..... 33

**Biancardi kundër Italisë –**  
[77419/16](#), Vendimi 25.11.2021 [Seksioni I] ..... 39

**Standard Verlagsgesellschaft mbH kundër Austrisë (nr 3) –**  
[39378/15](#), Vendimi 7.12.2021 [Seksioni IV] ..... 43

### II. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**Anev dhe Najdovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut,**  
A. nr. 17807/15 dhe A. nr. 17893/15,  
Aktgjykim i datës 3 shtator 2020 ..... 49

***Gelevski kundër Maqedonisë së Veriut,***

A. nr. 28032/12, Aktgjykim i datës 8 tetor 2020 ..... 52

***Memedov kundër Maqedonisë së Veriut,***

A. nr. 31016/17, Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 24 qershor 2021 ..... 57

***Kostova dhe Apostolov kundër Maqedonisë së Veriut,***

A. nr. 38549/16, Aktgjykim i datës 5 prill 2022 ..... 64

***A.A. dhe të Tjerë kundër Maqedonisë së Veriut,***

[55798/16](#), [55808/16](#), [55817/16](#) et al. Vendimi 5.4.2022 (Seksioni II) ..... 67

***Kostovski kundër Maqedonisë së Veriut,*** A. nr. 23773/17,

Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 7 qershor 2022 ..... 71

***Talevska dhe Tërçevska kundër Maqedonisë së Veriut,*** A. nr. 11828/16,

Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 28 qershor 2022 ..... 75

## I. AKTGJYKIMET E FUNDIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

### Neni 14

#### Diskriminimi

Mospërmbushja nga gjykatat vendase e detyrimit pozitiv për të kompensuar individët hebre dhe romë për deklaratimet publike diskriminuese të bëra nga politikani: *shkelje*

[Kjo përmbledhje mbulon gjithashtu edhe vendimin *Budinova dhe Chaprazov kundër Bullgarisë*, nr. [12567/13](#), i datës 16 shkurt 2021]

***Behar dhe Gutman kundër Bullgarisë*** –  
29335/13, Vendimi 16.2.2021 [Seksioni IV]

***Faktet*** – Kërkuesit, të etnisë hebre dhe rome, pretenduan që drejtuesi i një partie politike (politikani) kishte bërë deklaratime publike që përbënin ngacmime dhe nxitje për diskriminim ndaj hebrenjve nëpërmjet disa pasazheve në dy libra (në *Behar dhe Gutman*) dhe romëve në Bullgari në një numër deklaramesh të bëra në programet e televizionit, intervista, fjalime dhe në një libër (në *Budinova dhe Chapzarov*). Ata, ndër të tjera, argumentuan që secili prej tyre, si anëtar i minoritetit, ishte prekur personalisht nga këto deklaratime. Ankimet e kërkuesve u rrëzuan nga gjykatat vendase dhe ata bënë ankim, por pa sukses.

***Ligji*** – Neni 14 në lidhje me Nenin 8:

### *(a) Zbatueshmëria*

Çështja në këto raste ishte nëse deklaratimet publike negative të bëra në lidhje me një grup social mund të shiheshin sikur preknin ‘jetën private’ të individëve të këtij grupi deri në atë pikë sa të bëhej shkak për zbatimin e Nenit 8. Deklarimi i përgjithshëm në këtë fushë është dhënë në çështjen *Aksu kundër Turqisë*: për tu konsideruar i përshtatshëm për të ndikuar në ndjesinë e identitetit të një grupi etnik ose social dhe në ndjenjat e vetë-respektit dhe vetë-besimit të anëtarëve të këtij grupi deri në atë pikë sa të aktivizohet zbatueshmëria e Nenit 8, stereotipizimi negativ i grupit duhet të arrijë një nivel të caktuar. Kjo pikë mund të konstatohet mbi bazën e tërësisë së rrethanave të çështjes konkrete. Megjithatë, kategoritë e konsideratave që mund të kishin rëndësi në vlerësim mund të nxirreshin nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe nga qëndrimi i përgjithshëm në lidhje me zbatueshmërinë e Nenit 8 në çështjen *Denisov kundër Ukrainës* (DHM), në vijim i zbatuar edhe për çështje të tjera, në të cilat efekti negativ i një deklarimi ose një akti për ‘jetën private’ të dikujt duhej të ngrihej tej ‘pragut të ashpërsisë’.

Në çështjet si kjo e tashmja, faktorët e rëndësishëm për të vendosur nëse është i zbatueshëm Neni 8 përfshinte, por pa u kufizuar dosmosdoshmërisht:

1. Karakteristikat e grupit (për shembull madhësinë, shkallën e homogjenitetit, cënueshmërinë e posaçme ose historikun e stigmatizimit dhe pozicionin e tij përkundrejt shoqërisë si një e tërë);
2. Përmbajtjen e saktë të deklaratimeve negative në lidhje me grupin (veçanërisht, shkallën në të cilën ato mund të përçonin një stereotip negativ në lidhje me grupin si një i tërë dhe përmbajtjen specifike të atij stereotipi);

3. Formën dhe kontekstin në të cilën janë bërë deklaratimet, efekti i tyre (që mund të varet nga vendi dhe mënyra se si janë bërë), pozicioni dhe statusi i autorit të tyre, dhe masa në të cilën ato mund të konsiderohen të kenë ndikuar aspektin kryesor të identitetit dhe dinjitetit të grupit.

Është pikërisht ndërveprimi i këtyre faktorëve që ka rëndësi. Konteksti i përgjithshëm i secilës çështjeje, veçanërisht klima shoqërore dhe politike në momentin kur janë bërë deklaratimet, mund të jenë gjithashtu një konsideratë e rëndësishme.

Hebrenjtë (në *Behar dhe Gutman*) dhe romët në Bullgari (në *Budinova dhe Chaprazov*), të dy grupet e shënjestruara nga deklaratimet e politikanit, mund shiheshin si në një pozicion delikat.

Në rastin e parë, deklaratimet ishin intensivisht antisemite. Megjithëse disa prej tyre u referoheshin fakteve specifike, ato përsërisnin tregime të vjetra antisemite. Veçanërisht në lidhje me deklaratimet që mohonin realitetin e Holokaustit dhe paraqitjen e tij si një histori të shpikur si instrument për përfitime financiare, Gjykata dhe Komisioni i mëparshëm i kishin konsideruar këto deklarime si sulme ndaj komunitetit hebre dhe si nxitje për urrejtje racore, antisemitizëm dhe ksenofobi. Në lidhje me çështjen e fundit, deklaratimet dukeshin sikur ishin vendosur qëllimisht në terma provokues, duke u përpjekur dukshëm ti portretizonin romët në Bullgari sikur ishin jashtëzakonisht të prirur për krime dhe shturje. Ato ishin sistematike dhe karakterizoheshin nga intensiteti tyre ekstrem. Në të dy rastet, deklaratimet ishin shndërruar në stereotipe negativ ekstreme që synonin të përçmonin këto grupe dhe të nxisnin paragjykime dhe urrejtje ndaj tyre.

Ndërsa deklaratimet më të forta të politikanit në *Behar dhe Gutman* ishin bërë në dy libra që nuk ishin në qarkullim masiv, duke u

bërë në vijim kryetar i një partie politike në pushtet dhe që duke fituar vendin e dytë në një zgjedhje presidenciale disa vite më vonë, kjo do të shtonte masivisht në famën e keqe të deklarime të tij në lidhje me hebrenjtë. Në *Budinova dhe Chaprazov*, politikanin kishte përsëritur shpesh mesazhin e tij kryesor në shumë kanale të komunikimit dhe mund të pranohet që ky kishte arritur një audiencë të gjerë. Në momentin e bërjes së shumicës së deklarimeve të tij, ai ishte një figurë e mirë-njohur në shoqërinë bullgare dhe, për më tepër, qëndrimi i tij i fortë kundër romëve dukej sikur ishte pjesa thelbësore e mesazhit politik të partisë së tij. Në të dy rastet kërkuesit kishin paraqitur pretendimet e tyre ndaj politikanit në të njëjtën kohë kur karriera e tij politike ishte në ngritje dhe kur shprehjet e tij po bëheshin gjithmonë e më famëkeqe.

Duke patur parasysh të gjithë këta faktorë, të cilët orientojnë drejt të njëjtit drejtim dhe përforcojnë njeri-tjetrin, deklarimet e dënuara kanë qenë në gjendje për të patur një ndikim të mjaftueshëm në kuptimin e identitetit të hebrenjve dhe romëve në Bullgari dhe në ndjesitë e tyre të vetë-respektit dhe vetë-besimit, për të arritur ‘nivelin e caktuar’ ose ‘pragun e ashpërsisë’ së kërkuar. Në këtë mënyrë, këto kanë prekur ‘jetën private’ të kërkuesve. Kështu, Neni 8 dhe Neni 14 kanë qenë të zbatueshëm.

*(b) Nëse autoritetet kanë përmbushur detyrimin e tyre pozitiv*

Autoritetet nuk e kanë vlerësuar tonin e deklarimeve të politikanit në mënyrën e duhur. Megjithatë ato e kishin njohur intensitetin e tyre, atë e kishin nën-vleftësuar aftësinë e tyre për të stigmatizuar të grupet dhe nxitur urrejtjen dhe paragjykimet ndaj tyre, dhe mesa duket nuk i kishin parë deklarimet si diçka më shumë se pjesë e një debati legjitim në lidhje me çështjet e interesit publik. Megjithatë, mund të shihet lehtë në *Behar dhe Gutman* se dekla-



rimet e dënuara në dy librat e tij kishin si synim të shpifnin për hebrejtë dhe të nxisnin paragjykime dhe urrejtje ndaj tyre. E parë nën dritën e atyre deklarimeve të mëparshme dhe të debateve antisemite në të cilat ishte e përfshirë partia e tij politike, deklaramet e politikanit në tubimin parazgjedhor dhe në Parlament mund të shiheshin si të drejtuar, ndër të tjerash, kundër hebrenjve. Në *Budinova dhe Chaprazov*, deklaramet e tij kishin shkuar tej pjesës legjitime të një debati publik në lidhje me marrëdhëniet etnike dhe krimin në Bullgari, duke u shndërruar kështu në stereotipe negative ekstreme që synonin të shpifnin ndaj romëve në vend dhe të nxisnin paragjykime dhe urrejtje ndaj tyre.

Gjykata ka qenë gjithmonë e mendimit që deklaramet e përgjithshme duke sulmuar ose hedhur një dritë negative mbi të gjithë grupet etnike, fetare ose të tjera nuk kanë ose mund të kenë vetëm mbrojtje të kufizuar sipas Nenit 10, i lexuar nën dritën e Nenit 17. Kjo ishte tërësisht në pajtim me kërkesën që rrjedh nga Neni 14 për luftën kundër diskriminimit racor. Fakti që autori i këtyre deklarameve ishte një politikan ose kishte folur në cilësinë e anëtarit të Parlamentit nuk e ndryshonte këtë. Duke i përkushtuar një peshë të konsiderueshme lirisë së shprehjes së politikanit në lidhje me deklaramet e dënuara dhe duke nënvleftësuar efektin e tyre mbi të drejtën e kërkuar për respektimin e jetës private, që janë përkatësisht hebrejtë etnikë dhe romët etnikë që banojnë në Bullgari, gjykatat vendase kishin dështuar në realizimin e ushtrimit të balancës së kërkuar në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës. Duke refuzuar dhënien e zhdëmtimit kërkuar në lidhje me deklaramet diskriminuese të politikanit, ata kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre pozitive për të reaguar rregullisht ndaj diskriminimit për shkak të origjinës etnike të kërkuarve dhe për të siguruar respektimin e 'jetës së tyre private'.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: Konstatimi i shkeljes i mjaftueshëm në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu Aksu kundër Turqisë [DHM], [4149/04](#) dhe [41029/04](#), 15 mars 2012, [Përmbledhje Ligjore](#); Denisov kundër Ukrainës [DHM], [76639/11](#), 25 shtator 2018, [Përmbledhje Ligjore](#); Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë, [41288/15](#), 14 janar 2020, [Përmbledhje Ligjore](#))

## Neni 2

### Detyrime pozitive

Masat paraprake të autoriteteve të arsyeshme, megjithë disa gabime në planifikimin dhe zhvillimin e operacionit ndaj një individi të rrezikshëm, i cili vrau një nëpunës gjatë arrestimit: *nuk ka shkelje*

### Neni 2-1

#### Hetimi efektiv

Hetimi i paefektshëm në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e operacionit ndaj një individi të rrezikshëm, i cili vrau një nëpunës gjatë arrestimit: *ka shkelje*

**Ribcheva dhe të Tjerë kundër Bullgarisë** – 37801/16, 39549/16 dhe 40658/16, Vendimi 30.3.2021 [Seksioni IV]

**Faktet** - Kërkuesit janë nëna, babai dhe e bija e një nëpunësi të skuadrës së anti-terrorit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili u vra gjatë një operacioni nga personi që skuadra kërkonte të arrestonte. Në vijim të procedimit penal, personi që qëllloi u dënua, ndër të tjera, për vrasje me dashje në rrethana rënduese me burgim të përjetshëm dhe u urdhërua të zhdëmtonte kërkuesit. Megjithatë, kërkuesit u kërkuan autoriteteve të hetonin nëse nëpunësit kishin kontribuar në vdekjen e të afërmit të tyre duke urdhëruar dhe planifikuar në mënyrë të pasaktë operacionin, por këto refuzuan të fillonin një hetim të posaçëm penal. Megjithëse përfundimisht çështja u shqyrtua nga dy hetime të brendshme nga Ministria e sipër-përmendur, kërkuesit ngritën çështjen e efektivitetit të tyre.

### **Ligji** - Neni 2

(a) *Aspekti procedural*: Gjykata konstatoi që autoriteteve u ishte kërkuar të hetonin, përveç përgjegjshmërisë së drejtpërdrejtë të vrasësit, nëse nëpunësit kishin kontribuar në vdekjen e nëpunësit nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve neglizhente në planifikimin dhe zhvillimin e operacionit. Në fakt, nuk kishte shkak për të besuar që kjo detyrë hetimore, e cila doli pasi ishin humbur jetët në rrethanat që përfshinin përgjegjësinë e Shtetit për shkak të neglizhencës së pretenduar, nuk zbatohet në lidhje me nëpunësit e policisë të vrarë nga personat privatë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Megjithatë në rastin konkret autoritetet nuk e kishin përmbytur si duhet atë detyrë, duke mos respektuar kështu detyrimin procedural sipas Nenit 2. Veçanërisht, të dy hetimet e brendshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, megjithëse të përshtatshme në shumicën e pikëpamjeve, vuanin nga dy vese të rënda që i pengonin ato të përmbyshnin plotësisht kërkesat e Nenit 2: hetimi i dytë nuk kishte nisur me iniciativën e vetë autoriteteve siç kërkohet nga kjo dispozitë, por në bazë të ankimit të nënës së personit

të vdekur, dhe, ajo që është më e rëndësishme, kishte mungesë të plotë publiciteti dhe përfshirje të kërkuessve në të dy hetimet.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 2 (aspekti lëndor): Gjykata konfirmoi që detyrimi sipas Neni 2 në lidhje me marrjen e masave operacionale parandaluese për të mbrojtur jetën nga kërcënimet vdekjeprurëse nga individë të tjerë ishte njëlloj e zbatueshme për çdo aktivitet në të cilin rrezikohej e drejta e jetës. Ishte pikërisht ky detyrim i cili diskutohej në këtë rast. Ishte tepër e qartë për autoritetet që i afërmi i kërkuessve mund të rrezikohej nga objektivi, nëse ai merrte pjesë në operacion për arrestimin e tij - i cili mund të përshkruhej edhe si aktivitet i rrezikshëm i organizuar nga Shteti - dhe, në këtë mënyrë, kishte detyrimin pozitiv për të bërë gjithçka që normalisht mund të pritej për ta mbrojtur atë nga rreziku në kontekstin e atij operacioni. Më tej ajo theksoi që standardi i arsyeshmërisë në lidhje me këtë detyrim pozitiv (Neni 2, par 1) nuk ishte aq i rreptë sa ai në lidhje me detyrimin negativ për të mos përdorur forcë nëse 'ishte më shumë nga sa ishte absolutisht e nevojshme' (Neni 2, par 2). Autoritetet kishin një marzh vlerësimi dhe atyre nuk duhet tu vihet një barrë e pamundur ose jo-proporcionale, duke patur parasysh zgjedhjet operacionale që ato kishin në kuptimin e prioriteteve dhe burimeve, dhe paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore - veçanërisht kur bëhet fjalë për operacione aktive nga autoritetet e zbatimit të ligjit ndaj individëve të armatosur dhe të rrezikshëm. As edhe objekti dhe përmbajtja e detyrimit pozitiv të Shtetit për të mbrojtur personelin e vet të zbatimit të ligjit ndaj rreziqeve të jetë së tyre nuk duhet të bëjë të pamundur kërkimin ndaj tyre të përfshihen në këto operacione apo t'ua vështirësojë autoriteteve organizimin e tyre ë mënyrë të panevojshme. Nuk duhet harruar në këtë kontekst që personeli i zbatimit të ligjit i cili është

angazhuar vullnetarisht për të shërbyer - veçanërisht në njësitë e specializuara, detyrat e të cilëve përfshinin edhe përplasjen me terroristët dhe kriminelë të tjerë të rrezikshëm - duhet të jetë sigurisht i ndërgjegjshëm që kjo, sipas rastit, mund të vërë ata në situata ku ata mund të hasin kërcënime vdekjeprurëse, që mund të jenë të vështira për ti përballuar. Në të njëjtën kohë, autoritetet duhet të siguronin që ky personel të jetë i trajtuar dhe i përgatitur mirë. Gjykata nuk i hyri çështjes së pajisjeve dhe armëve të zjarrit që i ishte vënë në dispozicion skuadrës së anti-terrorit, pasi kjo u takonte autoriteteve të brendshme, që ishin më në gjendje për të vlerësuar kërkesat përkatëse dhe për të marrë përgjegjësi për zgjedhjet që duhen bërë për nevojat përkatëse, dhe të vendosin se si burimet e tyre të kufizuara duhet të ndahen në mënyrë që ata të mos jenë dukshëm të pajisur jo-mjaftueshëm për detyrën e tyre. Bazuar në këtë standard, Gjykata ishte e mendimit që megjithëse autoritetet kishin bërë gabime në planifikimin dhe ekzekutimin e operacionit, hapat që ata kishin ndërmarrë për të minimizuar riskun për jetën e nëpunësit të policisë mund të shiheshin si të arsyeshme dhe, në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet që ato kishin dështuar në detyrimin e tyre për të ndërmarrë hapat e arsyeshëm. Veçanërisht, ndërsa operacioni ishte nxituar në mënyrë të panevojshme dhe shkalla e mundshme e rezistencës së objektivit ishte nënvlerësuar, autoritetet kishin ndërmarrë masa paraprake të arsyeshme: ato kishin marrë informacione në lidhje me objektivin dhe kishin hartuar planin si të kryhej arrestimi i tij dhe sekuestrimi i armëve të tij të zjarrit; ato kishin angazhuar një numër nëpunësish të trajnuar posaçërisht dhe kishin vepruar në mënyrë të bashkërenduar, me një zinxhir të pandërprerë komande gjatë gjithë kohës. Gjykata duhej të ishte tepër e kujdesshme në lidhje me shqyrtimin e ndonjë prej zgjedhjeve që autoritetet kishin bërë në këtë aspekt duke patur njohuri të brendshme - gjë që duhet rezistuar edhe gjatë shqyrtimit nëse autoritetet kishin

përdorur forcën që ishte ‘më intensive nga sa është absolutisht e nevojshme’, ku, siç është vënë në dukje, zbatohet një standard shumë më i rreptë.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (unanimisht).

Gjykata ishte gjithashtu unanimisht e mendimit që nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa sipas Nenit 13 në lidhje me Nenin 2.

Neni 41: 8,000 EUR secilit kërkues në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. [28883/95](#), KEDNJ 2001-III; *Osmani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, Raporte mbi vendimet 1998-VIII, [Përmbledhje Ligjore](#); *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. [46477/99](#), KEDNJ 2002-II, [Përmbledhje Ligjore](#); *Stoyanovi kundër Bullgarisë*, nr. [42980/04](#), 9 nëntor 2010; *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [DHM], nr. [23458/02](#), KEDNJ 2011 (pjesë), [Përmbledhje Ligjore](#); *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. [41720/13](#), 25 qershor 2019, [Përmbledhje Ligjore](#))

## Neni 8

### Neni 8-1

#### Respektimi i jetës private

Reagimi i papërshtatshëm i autoriteteve vendase ndaj abuzimit verbal të një mësuesi të shkollës së mesme: *shkelje*

**F.O. kundër Kroacisë** - 29555/13, Vendimi 22.4.2021 [Seksioni I]

**Faktet** - Kërkuesi, student në një shkollë të mesme publike në kohën përkatëse, iu nënshtrua disa ofendimeve nga mësuesi i tij i matematikës (R.V.) Mësuesi i quajti kërkuesin, ndërmjet të tjerash, 'i trashë, idiot, budalla, malok'. Kërkuesi mori trajtim psikologjik në lidhje me ngjarjet. Babai i tij ua ankua në shkollë dhe disa organe të tjera përkatëse vendase, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit. Ankesat e babait duket se rezultuan në intervista ndërmjet psikologut të shkollës, R.V.-së dhe kërkuesit, dhe në një vlerësim të situatës nga Agjencia Arsimore. Kërkuesi paraqiti pa sukses edhe një kallëzim penal në polici, duke pretenduar ngacmim nga ana e R.V.-së.

Kërkuesi u ankua dhe nuk pati sukses edhe në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me ngacmimin nga mësuesi në shkollë dhe me reagimin e papërshtatshëm të autoriteteve përkatëse vendase.

### **Ligji** - Neni 8: (a) *Pranueshmëria*

Gjykata shqyrtoi zbatueshmërinë e Nenit 8 në çështjen konkrete. Masat e marra në fushën e arsimit në rrethana të caktuara ndikojnë të drejtën e respektimit të jetës private, por jo çdo akt ose masë që mund të konsiderohet se ndikon negativisht në integritetin moral të një personi domosdoshmërisht konsiderohet të jetë ndërhyrje (*Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Megjithatë, qysh nga çështja *Costello-Roberts*, ka patur një evolucion të qëndrimeve sociale dhe standardeve ligjore në lidhje me zbatimin e masave të disiplinës ndaj fëmijëve, duke theksuar nevojën e mbrojtjes së fëmijëve ndaj çdo forme dhune dhe abuzimi. Kjo është reflektuar në instrumente të ndryshme ndërkombëtare dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës (p.sh., *A, B dhe C kundër Letonisë, V.K. kundër Rusisë; Wetjen dhe të Tjerë kundër Gjermanisë*).

Ofendimet, të cilave u ishte nënshtruar kërkuesi nga R.V-ja, kishin shkaktuar trazirën e tij emocionale, gjë që kishte ndikuar në mirëqenien e tij psikologjike, dinjitetin dhe integritetin moral. Për më tepër, këto ofendime ishin shprehur në klasë para studentëve të tjerë dhe në këtë mënyrë ishin në gjendje të poshtëronin dhe ulnin kërkuesin në sytë e të tjerëve. Ofendimet në fjalë tregonin veçanërisht mungesë respekto ndaj kërkuesit dhe ishin kryer nga një mësues nga një pozitë autoritare dhe kontrolli mbi të. Në këto rrethana, si dhe duke marrë parasysh faktin që ishte në interesin më të lartë të kërkuesit si fëmijë që shokët e tij të klasës dhe fëmijët në përgjithësi të mbroheshin me efektivitet ndaj çdo dhune dhe abuzimi në mjediset edukative, trajtimi i ankimuar duhet të shqyrtohet nën dritën e së drejtës së respektit për jetën private, brenda kuptimit të Neni 8.

Duke konstatuar që Neni 8 ishte i zbatueshëm dhe duke paratur parasysh edhe kontekstin e çështjes (d.m.th., pretendimet e ngacmimit në shkollë në duart e një mësuesi, ku çdo formë dhunë, sado e pakët që të jetë, konsiderohen e papranueshme), Gjykata konstatoi gjithashtu që nuk ka vend për zbatimin e kriterit të disavantazhit të pakonsiderueshëm. Kështu ajo e rrëzoi kundërshtimin e Qeverisë në këtë pikëpamje.

#### (b) *Themeli*

Nuk ishte dyshim që trajtimi i cili sillte këto pasoja për kërkuesin, i kryer nga një mësues në një shkollë publike, ndërsa kërkuesi ishte nën kontrollin e tij, kishte arritur nivelin e një ndërhyrjeje sipas Neni 8 (shih *mutatis mutandis*, V.K. kundër Ruisisë) Duhej të përcaktohej nëse një ndërhyrje e tillë ishte e justifikuar apo jo. Në bërjen e këtij vlerësimi, Gjykata kishte parasysh faktin që kërkuesi ishte ankuar jo vetëm për ngacmimin nga mësuesi, por



gjithashtu për mosreagimin nga ana e autoriteteve përkatëse në lidhje me pretendimet e ngacmimit:

*(i) Pretendimet e kërkuarit për ngacimin nga mësuesi*

Ndërsa ofendimet e para të R.V.-së ndaj kërkuarit kishin synimin e disiplinimit të tij dhe shokëve të tij të klasës për shkak të ardhjes vonë në klasë, dy herët e fundit nuk mund të shiheshin si gjë tjetër përveç se abuzim verbal pa shkak ndaj kërkuarit që arrinte nivelin e poshtërimit, uljes dhe talljes. Në asnjë rast nuk mund të gjendet justifikim për sjelljen e R.V.-së. R.V.-ja, si mësues, ishte vendosur në pozitën unike të autoritetit mbi kërkuarin, i cili i kishte bërë veprimet e tij të dukshme për një ndikim të konsiderueshëm mbi dinjitetin, mirëqenien dhe zhvillimin psikologjik të kërkuarit.

Abuzimi verbal nuk kishte qenë në një shkallë të lartë intensiteti dhe nuk kishte degjeneruar më tej në një ngacim të zakonshëm. Megjithatë, R.V.-ja, si mësues, pritej të kuptonte që efektet e provokimit dhe abuzimit verbal mund të ndikojnë thellë studentët, veçanërisht ata që ishin më të ndjeshëm. Megjithatë, duke qenë mësues, ai duhej të ishte i ndërgjegjshëm që çdo formë dhune, duke përfshirë abuzimin verbal, ndaj studentëve, sado i butë, nuk ishte i pranueshëm në një mjedis edukativ dhe që atij i kërkohej të ndërvepronte me studentët me respektin e duhur për dinjitetin dhe integritetin e tyre moral. Për pasojë, duke pagur parasysh pozicionin e besimit, autoritetit dhe ndikimit, si dhe të përgjegjësitë sociale që kanë mësuesit, nuk kishte vend për tolerimin e asnjë ngacimi nga mësuesi përkundrajt një studenti. Shpeshësia, ashpërsia e dëmit dhe dashakeqja nuk ishin parakushte për përkufizimin e dhunës dhe abuzimit në një kontekst edukativ.

*(ii) Reagimi i autoriteteve vendase ndaj pretendimeve për ngacmim të kërkuesit*

Gjykata konstatoi që autoritetet vendase, duke pagur një marzh diskrecioni, duhej të merrnin masat e duhura legjislative, administrative, sociale dhe edukative për të ndaluar gjithmonë qartazi çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve dhe në të gjitha rrethanat, dhe në këtë mënyrë të siguronin tolerancën zero për çdo dhunë apo abuzim në institucionet edukative. Kjo kishte të bënte edhe me domosdoshmërinë e garantimit të përgjegjshmërisë nëpërmjet procedurave të përshtatshme penale, civile, administrative dhe profesionale.

Në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata nuk ishte e mendimit që zbatimi i procedurës civile ishte e domosdoshme për përmbyshjen e detyrimeve të Shtetit sipas Nenit 8, dhe në këtë mënyrë shqyrtoi më tej mënyrën në të cilën ishin trajtuar pretendimet e kërkuesit brenda procedurave të disponueshme administrative dhe profesionale.

Pas ankesës fillestare të kërkuesit tek drejtori në lidhje me ngacmimin nga R.V.-ja, nuk ishte marrë asnjë masë konkrete nga autoritetet shkollë, derisa babai i tij u dërgoi letra autoriteteve të ndryshme shtetërore duke u kërkuar që kërkuesi të mbrohen nga ngacmimi i mëtejshëm në shkollë. Ndërkohë, kërkuesi u ishte nënshtruar edhe dy rasteve të tjera të abuzimit verbal nga R.V.-ja.

Autoritetet shkollë kishin organizuar një proces pajtimi ndërmjet kërkuesit dhe R.V.-së. Në këtë proces, e vetmja masë e marrë në lidhje me R.V.-në kishte të bënte me një vërejtje gojore nga psikologu i shkollës. Megjithatë, nuk ishte marrë asnjë vendim apo masë në lidhje me sjelljen e R.V.-së, dhe as ishin filluar procedurat përkatëse profesionale administrative në Ministri. Një pro-

ces i tillë pajtimi duket se është haptazi joefektiv. Autoritetet vendase kishin dështuar të njihnin që, ajo për të cilën bëhej fjalë, nuk ishte vetëm sqarimi i gjërave ndërmjet kërkuesit dhe R.V-së, por domosdoshmëria e përballjes dhe trajtimit të problemit që dilte nga sjellja e papranueshme e R.V-së që kishte prekur jo vetëm kërkuesin por edhe disa studentë të tjerë gjithashtu. Shkolla kishte dështuar gjithashtu të reagoje në ndonjë mënyrë në lidhje me kërkesën e kërkuesit për tu transferuar tek një klasë tjetër ose ti caktohej një mësues tjetër matematike në klasën e tij.

Ministria kishte reaguar vetëm pas një kërkesë të posaçme të bërë nga babai i kërkuesit. Ajo ia kishte kaluar çështjen Agjencisë Arsimore për mbikëqyrjen e saj pedagogjike dhe edukative. Megjithatë, nuk kishte asnjë tregues që inspektorati arsimor i Ministrisë kishte konsideruar marrjen e ndonjë mase tjetër brenda kompetencës së tij për të trajtuar ankesat specifike të bëra nga kërkuesi, si intervistimi i kërkuesit apo marrja e masave përkatëse për të mbrojtur studentët, duke ofruar trajnim të posaçëm për mësuesin dhe, sipas rastit, fillimin e procedimeve përkatëse. Në kontekstin e mbikëqyrjes së saj pedagogjike, Agjencia ishte përqendruar në mënyrën e dhënies së leksioneve matematikore nga R.V.-ja, pa zhvilluar asnjë hetim në lidhje me ngjarjet në fjalë. Konkluzionet e arritura nga Agjencia ishin të dyshimta duke patur parasysh pretendimet që disa studentë nuk i ishin përgjigjur me ndershmëri pyetësorit të Agjencisë për shkak të frikës së hakmarrjes. Për më tepër, përfundimet e Agjencisë sugjerorin që çështja të zgjidhej në një diskutim të mëtejshëm ndërmjet autoriteteve shkollore dhe babait të kërkuesit: Gjykata nuk e kupton se si kjo mund të konsiderohet një masë e përshtatshme.

Gjithashtu nuk kishte asnjë tregues që Agjencia apo Ministria i kishin ndjekur zhvillimet e mëtejshme në rastin e kërkuesit

ose situatën e tij në shkollë. Në këtë kuptim, ishte e vështirë të pranohet që një letër e vetme nga drejtori, i cili pretendon se babai i kërkuarit kishte deklaruar që çështja ishte zgjidhur, mund të konsiderohet e mjaftueshme. Në fakt, nuk ka asnjë tregues që përmbajtja e kësaj letre të ishte autorizuar nga babai i kërkuarit. Duhej të ishte e qartë për administratën arsimore të shtetit që lloji i sjelljes së kundërshtuar dhe efektet e saj mbi kërkuarin kërkonin një investim më të kujdesshëm njohurish dhe burimesh për të kuptuar pasojat dhe implikimet e saj, duke dështuar kështu në ofrimin e kujdesit të përshtatshëm dhe të pritshëm për kërkuarin e në shkollë.

Në tërësi, autoritetet shtetërore nuk kishin reaguar me kujdesin e duhur ndaj pretendimeve të kërkuarit në lidhje me ngacmimin në shkollë.

**Përfundim:** shkelje (4 vota me 3).

Neni 41: 7,500 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, [13134/87](#), 25 mars 1993, [Përmbledhje Ligjore](#); *A, B dhe C kundër Letonisë*, [30808/11](#), 31 mars 2016; *V.K. kundër Rusisë*, [68059/13](#), 7 mars 2017, [Përmbledhje Ligjore](#); *Wetjen dhe të Tjerë kundër Gjermanisë*, [68125/14](#) dhe [72204/14](#), 22 mars 2018, [Përmbledhje Ligjore](#))

**Polat kundër Austrisë** - 12886/16, Vendimi 20.7.2021 [Seksioni IV]

**Faktet** - I biri i kërkuarës pati lindje të parakohshme dhe vdiq dy ditë

më vonë. Ai ishte diagnostikuar me një sëmundje të rrallë kështu që mjekët që e trajtuan vendosën që një vizitë pas vdekjes do të ishte e nevojshme për të sqaruar diagnozën. Kërkuesja dhe bashkëshorti i saj e refuzuan këtë për arsye fetare dhe shpjeguan që ata dëshironin të varrosnin djalin e tyre në pajtim me zakonet myslimane që kërkonin që trupi të mbetej sa më i paprekur që të jetë e mundur. Megjithë kundërshtimet, vizita pas vdekjes u krye dhe praktikisht fëmijës i ishin hequr organet e brendshme. Duke mos qenë e informuar në lidhje me masën e ndërhyrjes pas vdekjes, kërkuesja besoi që ajo mund ta varroste të birin e saj sipas zakonit; ajo erdhi në dijeni të masës së ndërhyrjes faktike gjatë ceremonisë së organizuar në Turqi, e cila për pasojë duhej të anulohet. Kërkuesja ngriti padi civile për zhdëmtim por nuk pati sukses.

**Ligji** - Neni 8 dhe Neni 9 (*kryerja e vizitave pas vdekjes megjithë kundërshtimet e kërkueses*): Në rastin konkret ka patur një ndërhyrje, e cila ishte e parashikuar në ligjin e brendshëm, në jetën private dhe familjare të kërkueses, si dhe në të drejtën e saj për të manifestuar fenë e saj. Për më tepër, vizita pas vdekjes ishte kryer për të garantuar interesin shkencor dhe i shërbente një qëllimi legjitim për mbrojtjen e jetës së të tjerëve. Në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes, Gjykata qysh në fillim theksoi së çështja kishte të bënte me rregullimin e vizitave pas vdekjes në spitalet publike dhe çështjen nëse dhe në cilat raste të afërmve të afërt të të ndjerit duhej tu jepej e drejta për të kundërshtuar një vizitë pas vdekjes për shkaqe të lidhura me jetën private dhe fenë, nëse interesi publik e kërkon qartazi një masë të tillë. Në këtë kontekst, Shtetet Kontraktuese kishin detyrimin pozitiv, në sajë të Nenit 8, të merrnin masat e përshtatshme për të mbrojtur shëndetin e personave nën juridiksionin e tyre; kështu, marzhi i diskrecionit të Shteteve ishte i konsiderueshëm. Në vijim Gjykata konstatoi sa më poshtë:

Nuk kishte asnjë shkak të viheshin në pikëpyetje konstatimet e mjekut si ekspert që vizita pas vdekjes ishte kryer në bazë të ligjit ose të zgjedhjes legjislative të vendit për të mos lejuar të drejtën e kundërshtimit nga të afërmit e afërt të vizitës pas vdekjes për shkaqe fetare apo të tjera në të gjitha rastet; të drejta e Neneve 8 dhe 9 nuk ishin absolute dhe në këtë mënyrë nuk kërkonin që Shtetet Kontraktuese të jepnin një të drejtë absolute për të paraqitur një kundërshtim në këtë aspekt.

Megjithëse ligjet përkatëse të brendshme nuk u jepnin autoriteteve të drejtën për të kryer vizita pas vdekjes në secilin rast të veçantë, legjislativi austriak kishte zgjedhur t'u jepte prioritet interesave të shkencës dhe shëndetit të të tjerëve përkundëjt arsyeve fetare apo të tjera për kundërshtimin nga ana e të afërmeve të të ndjerit, në rastet e dosmosdoshmërisë për garantimin e interesave shkencore, veçanërisht në rastin kur diagnostikimi nuk kishte qenë i qartë. Nga ky këndvështrim, Gjykata theksoi parashtrimet e Qeverisë në lidhje me rëndësinë e këtyre vizitave pas vdekjes për përparimin e shkencës moderne, si dhe traditën e gjatë dhe të ruajtur me kujdes të ligjit të autopsisë në Austri, i cili perceptohej si një pjesë përbërëse e lirisë së shkencës të garantuar në kushtetutë; një e drejtë e lidhur ngushtë me të drejtat pozitive sipas Nenit 2 dhe 8 për marrjen e masave të përshtatshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave brenda juridiksionit të një Shteti. Qëllimi legjitim i mbrojtjes së shëndetit të të tjerëve nëpërmjet kryerjes së vizitave pas vdekjes ishte e një rëndësie dhe e një peshe të posaçme në rastin konkret. Në të njëjtën kohë, Gjykata merr në konsideratë rëndësinë e interesit të kërkueses në këtë kontest, për të siguruar që trupi i të birit të saj të ndjerë të respektohej për qëllimin e varrimit, një shqetësim që ajo e kishte shprehur nga fillimi.

Duke patur parasysh provat e marra gjata gjykimit të brendshëm, Gjykata është e bindur që, në pajtim me konstatimet e gjykatave të brendshme, kërkesa ligjore që, për kryerjen e një vizite pas vdekjes, duhet të ekzistojë një interes shkencor, është përm-bushur. Megjithatë, ligji i brendshëm lejon një fushë të caktuar diskrecioni për mjekët që vendosnin në çdo rast konkret nëse duhet të kryhet një vizitë pas vdekjes dhe në lidhje me masën e nevojshme të ndërhyrjes. Kështu kjo nuk e përjashton balancimin e të drejtave dhe interesave konkurruese që mund ose duhej të ishte kryer. Kështu, arsyet e kërkueses për kundërshtimin e vizitës pas vdekjes nuk ishin marrë parasysh nga personi i spitalit. As Gjykata e Apelit, në vendim-marrjen në lidhje me pretendimin e saj për kompensim, nuk e kishte peshuar rëndësinë e interesit publik në vizitën pas vdekjes përkundrejt interesit të saj të posaçëm privat për pasjen e trupit të të birit të saj ‘sa më të paprekur që të jetë e mundur’ për varrimin fetar. Për më tepër, megjithëse Gjykata e Lartë e kishte adresuar, deri në një farë mase, proporcionalitetin e ndërhyrjes tek të drejtat e saj, ajo u kishte kushtuar pas ose aspak konsideratë arsyeve të saj për kundërshtimin e vizitës pas vdekjes, në këtë mënyrë duke trajtuar në masë të pamjaftueshme të drejtat e saj individuale sipas Nenit 8 dhe 9 dhe domosdoshmërinë e vizitës pas vdekjes në këtë aspekt.

Për pasojë, megjithë marzhin e gjerë të diskrecionit të dhënë autoriteteve të brendshme, këto në rastin konkret nuk kishin gjetur balancën e drejtë ndërmjet interesave konkurruese në fjalë, për të përputhur kërkesat për shëndetin publik në masën me të lartë të mundshme me ato për të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, dhe as kishin vënë në balancë interesin e kërkueses për varrimin e të birit të saj në pajtim me besimin e saj fetar.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 8 (në lidhje me detyrimin e spitalit për të dhënë informacion në lidhje me vizitën pas vdekjes): Meqenëse themeli i ankesës së kërkueses nuk ishte se Shteti kishte vepruar në një mënyrë të caktuar, por që ai nuk kishte vepruar, Gjykata e pa çështjen nga këndvështrimi i një detyrimi pozitiv nga ana e Shtetit të paditur sipas Nenet 8.

Megjithëse duhet se nuk ka ndonjë rregull të prerë në ligjin e brendshëm që rregullon masën e informacionit që duhet ose nuk duhet tu jepet të afërmeve të afërt të një personit të ndjerë në lidhje me të cilin është bërë një vizitë pas vdekjes, kjo nuk është në vetvete e mjaftueshme për të gjetur një shkelje të detyrimeve pozitive të Shtetit të paditur. Kështu, në këto rrethana, çështja ishte nëse autoritetet kishin ndërmarrë hapat e arsyeshëm për ti dhënë kërkueses informacion në lidhje me ndërhyrjen gjatë vizitës pas vdekjes, dhe në lidhje me heqjen dhe vendndodhjen e organeve të tij. Gjykata këtyre iu përgjigj negativisht. Rrethanat e çështjes ishin faktikisht po aq delikate sa edhe në çështjen *Hadri-Vionnet kundër Zvicrës* dhe kërkonte një shkallë po aq të lartë kujdesi dhe maturie nga ana e personit të spitalit gjatë ndërveprimit me kërkuesen. Kërkuesja, e cila sapo kishte humbur fëmijën e saj, u gjend pa të drejtë ligjor për të kundërshtuar një vizitë pas vdekjes. Ajo kishte informuar personelin e spitalit në lidhje me arsyet e kundërshtimeve të saj dhe që, sipas besimeve të saj fetare, trupi i fëmijës së saj të ndjerë duhej të ishte sa më i paprekur të ishte e mundur për ceremoninë e varrimit. Për pasojë, ata kishin një detyrim akoma më të madh për ti dhënë asaj informacionin e nevojshëm në lidhje me atë që ishte bërë dhe çfarë do të bëhej me trupin e fëmijës së saj, dhe pa vonesë të panevojshme, informacionin në lidhje me heqjen dhe vendndodh-



jen e organeve të tij. Ata nuk e bënë këtë, duke e bërë, në këtë mënyrë, të besonte se një larje sipas zakonisht dhe një ceremoni varrimi mund të kryeshin sipas besimit të saj. Ndërsa argumenti i Gjykatës së Lartë se mosdhënia e informacionit të detajuar do të ishte më pak e rëndë për të afërmit mund të jetë i vlefshëm në disa situata, ai nuk merrte parasysh situatën specifike në rastin e kërkueses dhe dëshirat e saj të veçanta që i ishin komunikuar spitalit në disa raste. Siç konstatoi edhe Gjykata, nuk mund të konsiderohet e ditur që të gjitha organet hiqen gjatë një vizite të një foshnje pas vdekjes së saj. Gjithashtu mbeti e padiskutuar që personeli i gjykatës fillimisht mohoi se kishte hequr ndonjë organ, por më vonë pranoi që ata faktikisht e kishin bërë këtë. Kërkueses i ishin dhënë organet e të birit të saj vetëm pas dy ndërhyrjeve nga Ombudsmeni i Pacientëve.

Në tërësi, sjellja e personelit të spitalit ndaj kërkueses qartazi nuk e kishte kujdesin dhe maturinë që kërkohet nga situata përkatëse. Dhe e fundit por jo më pak e rëndësishmja, ndërsa opinionet e ekspertëve kishin konstatuar njëzëri se vizita pas vdekjes ishte e justifikuar për të qenë në gjendje të qartësonin diagnozën, atje nuk përmendej asgjë në lidhje me domosdoshmërinë e mbajtjes së organeve për arsye shkencore apo të tjera për disa javë ose muaj.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 10 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

(Shih gjithashtu *Hadri-Vionnet kundër Zvicrës*, [55525/00](#), 14 shkurt 2008, [Përmbledhje Ligjore](#); *Solska dhe Rybicka kundër Polonisë*, [30491/17](#) dhe [31083/17](#), 20 shtator 2018, [Përmbledhje Ligjore](#); *Vavříčka dhe të Tjerë*

*kundër Republikës Çeke* [DHM], [47621/13](#) et al., 8 prill 2021, [Përmbledhje Ligjore](#))

## **Neni 6**

### **Çështje civile**

#### **Neni 6-1**

#### **Aksesi në gjykatë**

#### **Të drejtat dhe detyrimet civile**

Pamundësia e ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të Ukrainës për të kundërshtuar përjashtimin e ushtrimit të funksioneve gjyqësore pas reformës legislative: *shkelje*

## **Neni 8**

#### **Neni 8-1**

#### **Respektimi i jetës private**

Përjashtimi i paligjshëm i ish-gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të Ukrainës nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore pas reformës legislative: *shkelje*

***Gumenyk dhe të Tjerë kundër Ukrainës*** - 11423/19, Vendimi 22.7.2021 [Seksioni V]

**Faktet** - Pas ndryshimeve legislative të vitit 2016, Gjykata e Lartë e Ukrainës (GJLU) u suprimua dhe u zëvendësua nga Gjykata e re e Lartë (GJL), ku vendet e saj u plotësuan ekskluzivisht nëpërmjet garës. Tetë kërkuesit ishin gjyqtarë të GJLU-së dhe si rezultat i ndryshimeve ligjore, qysh nga fillimi i aktivitetit të GJL-së në dhjetor 2017, ata u përjashtuan nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore pa u larguar formalisht nga detyra. Kjo ndodhi pavarësisht një vendimit të datës 18 shkurt 2020 të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të një ankimi të mbledhjes së përgjithshme të GJLU-së, që i deklaronte masat përkatëse legislative në kundërshtim me Kushtetutën dhe konfirmonte vlefshmërinë e mandatit të kërkuesve.

**Ligji** – Neni 6 § 1: Qysh në fillim Gjykata theksoi që Konventa nuk i pengon Shtetet të marrin vendime legjitime dhe të nevojshme për të reformuar gjyqësorin. Ajo ishte në dijeni në lidhje me sfondin e komplikuar dhe kontekstin e reformës gjyqësore të debatuar në Ukrainë dhe ishte e mendimit që nuk ishte roli i saj të shprehej në lidhje me qëllimet apo përshtatshmërinë, apo të përcaktonte nëse ajo ishte e legjitimuar sipas së drejtës kushtetuese ukrainase. Ajo që duhej të shqyrtohej në rastin konkret ishte nëse mënyra në të cilën ishte zbatuar reforma kishte prekur të drejtat e kërkuesve sipas Konventës.

#### (a) *Zbatueshmëria*

(i) *Ekzistenca e një të drejte* - Fillimisht, kërkuesit e kishin të drejtën sipas së drejtës së brendshme të mbeteshin gjyqtarë deri në daljen në pension, për sa kohë nuk materializohet asnjë nga shkaqet e veçanta të parashikuara në Kushtetutë për largimin e parakohshëm nga detyra. Së dyti, sipas parimeve përkatëse kushtetuese ata kishin të paktën një bazë të argumentuar për të pretenduar të drejtën të mbroheshin ndaj largimit arbitrar nga de-

tyra në gjyqësor. Së treti, objekti i saktë i së 'drejtës' së kërkuesve në këtë kontekst ishte e përcaktuar dhe artikuluar qartë në të drejtën e brendshme nga Gjykata Kushtetuese që e kishte bërë të qartë në vendimin e saj që ata kishin një të drejtë të mbeteshin gjyqtarë në organin më të lartë gjyqësor. Për pasojë, dhe duke patur parasysh edhe rolin e funksioneve gjyqësore që kërkuesit ishin penguar të ushtronin, kishte një debat të vërtetë dhe serioz në lidhje me një 'të drejtë' që kërkuesit mund ta pretendonin duke patur shkaqe të bazuara në të drejtën e brendshme.

(ii) *Natyra civile e së drejtës* - Mosmarrëveshja e kërkuesve nuk ishte në lidhje me shpërblimin, por me paaftësinë e tyre për të ushtruar mandatin si gjyqtarë, gjë që kishte efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e tyre profesional dhe personal dhe në mundësinë e vendosjes së raporteve me të tjerë. Këto aspekte të së drejtës private të çështjes ishin thelbësore dhe nuk mund të mbuloheshin nga natyra publike e punësimit të kërkuesve. Për më tepër, duke patur parasysh natyrën e masave të njëanshme të kundërshtuara dhe efektet e tyre të konsiderueshme mbi jetën profesionale të kërkuesve dhe ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore, përjashtimi i mosmarrëveshjes konkrete nga mbrojtja e Nenit 6 do të ishte jo vetëm artificiale, por do të minonte mbrojtjen e rolit të gjyqësorit në shoqëri.

Për të përcaktuar nëse e drejta e pretenduar nga kërkuesit ishte 'civile', Gjykata aplikoi kriteret e zhvilluara në vendimin Vilho Eskelinen dhe të Tjerët kundër Finlandës (DHM). Megjithëse në këto rrethana duket sikur kërkuesit nuk e kishin patur të drejtën e aksesit në një gjykatë sipas së drejtës së brendshme në lidhje me pretendimin e tyre, gjykata ishte e mendimit që nuk ishte e nevojshme të jepej një mendim përfundimtar sipas kushtit të parë të testit Eskelinen, meqenëse kushti i dytë i këtij testi nuk ishte

përmbushur. Posaçërisht, duke patur parasysh garancitë për pavarësinë e gjyqësorit, Gjykata ishte e mendimit që do të ishte gabim të merrej e mirëqenë se gjyqtarët mund të ruanin parimet e shtetit së drejtës dhe zbatonin Konventën nëse ligji i brendshëm u hiqte atyre garancitë e Neneve të Konventës për çështjet që prekin drejtpërdrejt pavarësinë dhe paanësinë e tyre individuale. Kështu nuk ishte e justifikuar të përjashtoheshin anëtarët e gjyqësorit nga mbrojtja e Neni 6 në çështjet që kishin të bënin me kushtet e punësimit të tyre mbi bazën e lidhjes së posaçme të besnikërisë dhe besimit ndaj Shtetit. Në këtë mënyrë, Neni 6 ishte i zbatueshëm sipas aspektit të tij civil.

(b) *Themeli* - E drejta e aksesit për në gjykatë ishte një nga të drejtat procedurale themelore për mbrojtjen e anëtarëve të gjyqësorit dhe kërkuesit duhej që, në parim, të gëzonin aksesin e drejtpërdrejt në gjykatë në lidhje me pretendimet e tyre për përjashtimin e paligjshëm nga ushtrimi i funksioneve të tyre gjyqësore. Megjithëse mundësia e masave institucionale, si ajo e filluar nga mbledhja e përgjithshme e GJLU-së në rastin konkret, mund të jetë një garanci shtesë, kjo nuk mund të zëvendësonte të drejtën e një anëtari të gjyqësorit për të ngritur padi në cilësinë e tij ose të saj personale. Ishte e vështirë të kuptohej se si mund të arriheshin qëllimet e garantimit të një gjyqësori të brendshëm të drejtë dhe të përshpejtimit të gjyqësorisë të brendshme të përcaktuara në relacionin e projekt-ligjit për reformën gjyqësore duke kufizuar aksesin e kërkuesve në gjykatë në lidhje me pretendimet e tyre për përjashtimin e tyre nga ushtrimi i funksioneve të tyre gjyqësore. Në këto rrethana, mungesa e aksesit në gjykatë nuk ishte normalisht proporcionale me synimin legjitim të kërkuar.

**Përfundimi:** shkelje (unanimisht).

## Neni 8

(a) *Zbatueshmëria* - Në këto rrethana, Gjykata aplikoi metodën e bazuar në pasojat: duke patur parasysh natyrën dhe kohëzgjatjen e efekteve negative mbi kërkuesit, ajo konstatoi që masat e kundërshtuara kishin prekur jetën e tyre private në një shkallë shumë të lart, duke u përfshirë kështu në objektin e Nenit 8. Veçanërisht, masat e kundërshtuara, megjithëse nuk lidheshin drejtpërdrejt me kërkuesit, u kishin hequr atyre mundësinë për të vazhduar aktivitetin e tyre në gjyqësor dhe të jetonin në një mjedis profesional kur ata mund të ndiqnin qëllimet e tyre të zhvillimit profesional dhe personal. Në kohën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, këto efekte lëndore nuk ishin vënë në vend pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që konfirmonte zbatueshmërinë e parimit të patundshmërisë së tyre në këtë aspekt.

(b) *Themeli* - Çështja kryesore në rastin konkret është nëse ndërhyrja tek e drejta e kërkuesit për respektimin e jetës private, e cila rrjedh nga një ligj i parlamentit, kishte qenë e ligjshme për qëllimet e Konventës. Gjykata konstatoi që nuk ishte. Në këtë kontekst, ajo i kushtoi rëndësi vendimit të Gjykatës Kushtetuese që i deklaronte masat përkatëse legislative si jo-kushtetuese dhe, posaçërisht konstatimeve të saj që: ndryshimet Kushtetuese nuk e shkelnin parimin e vazhdimësisë institucionale të organit më të lartë gjyqësor, i cili vazhdonte të funksiononte nën emërtimin ‘Gjykatë e Lartë’; ri-emërtimi i organit gjyqësor të parashikuar në Kushtetutë nuk mund të realizohej pa transferimin e gjyqtarëve të GJLU-së në postet e gjyqtarëve të GJL-së, pasi nuk kishte asnjë ndryshim në statusin e tyre ligjor; heqja e fjalës ‘Ukrainës’ nga shprehja ‘Gjykata e Lartë e Ukrainës’ nuk mund të justifikonte largimin e të gjithë gjyqtarëve të GJLU-së ose transferimin e tyre në një gjykatë tjetër. Kështu, gjyqtarët e GJLU-së duhej të

vazhdonin të ushtronin kompetencat e tyre di gjyqtarë të GJL-së. Diferencimi ndërmjet gjyqtarëve të GJLU-së dhe GJL-së nuk ishte në pajtim me parimin e patundshmërisë së gjyqtarëve, që ishte pjesë e garancisë kushtetuese të pavarësisë së gjyqësorit. Për më tepër, Qeveria nuk kishte treguar që mënyra me të cilën kërkuesit ishin detyruar të konkurronin me qëllim që të mbanin të drejtën e tyre për të ushtruar funksionet e tyre gjyqësore dhe, veçanërisht, mënyra në të cilën ishte organizuar gara, duke përfshirë edhe zgjedhjen e anëtarëve të komisionit dhe mungesën e garancive institucionale dhe procedurale, mund të ishin në pajtim me parimet Kushtetuese të mbrojtjes së përgjithshme të të drejtave individuale dhe me garancitë specifike në lidhje me marrëdhënien e postit të gjyqtarit duke përfshirë patundshmërinë e gjyqtarëve që, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe të Këshillit të Europës, ishte një element kyç për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe besimit të publikut në gjyqësor.

Megjithatë, megjithë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, çështja e vazhimit të ushtrimit të funksioneve gjyqësore nga kërkuesit ishte shqyrtuar edhe nga Parlamenti dhe, meqenëse GJL-ja kishte filluar të funksiononte, kërkuesit nuk kishin qenë në gjendje të ushtronin funksionet e tyre gjyqësore si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Kështu, ekzistonte një mungesë e qartë bashkërendimi në trajtimin e situatës së kërkuesve për një periudhë të konsiderueshme që kishte dëmtuar rëndë sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e parimeve kushtetuese për pavarësinë e gjyqësorit.

***Përfundimi:*** shkelje (unanimisht).

Neni 41: 5 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar për secilin kërkues; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

(Shih gjithashtu *Vilho Eskelinen dhe të Tjerë kundër Finlandës* [DHM], [63235/00](#), 19 prill 2007, [Përmbledhje Ligjore](#); *Baka kundër Hungarisë* [DHM], [20261/12](#), 23 qershor 2016, [Përmbledhje Ligjore](#); *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], [76639/11](#), 25 shtator 2018, [Përmbledhje Ligjore](#); *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], [55391/13](#) et al., 6 nëntor 2018, [Përmbledhje Ligjore](#); *Bilgen kundër Turqisë*, [1571/07](#), 9 mars 2021)

## Neni 10

### Neni 10-1

#### Liria e shprehjes

Vendosja e sanksioneve civile ndaj një redaktori për shkak të refuzimit për një kohë të gjatë të heqjes së një artikulli në lidhje me një çështje penale ndaj personave privatë, i cili mund të aksesohet lehtësisht duke futur emrin e këtyre të fundit në makinën e kërkimit të Internetit: *nuk ka shkelje*

***Biancardi kundër Italisë*** - 77419/16, Vendimi 25.11.2021 [Seksioni I]

***Faktet*** - Kërkuesi, kryeredaktor i një gazete online, publikoi një artikull në lidhje me një konfrontim të dhunshëm, i pasuar me një plagosje me thikë, i cili kishte ndodhur në një restorant, dhe gjykimin përkatës penal. Një prej të akuzuarve dhe restoranti kërkuan largimin e artikullit nga Interneti. Kërkuesi fillimisht e refuzoi këtë, por eventualisht, tetë muaj më pas, e largoi artikullin,



si një përpjekje për të zgjidhur çështjen që ata kishin filluar para gjykatave të brendshme. Këto të fundit, megjithatë, e deklaruan kërkuesin fajtor që nuk e kishte larguar atë për një periudhë të caktuar kohe, megjithë kërkesat formale të paditësve, duke lejuar në këtë mënyrë që gjithkush të hynte tek informacioni në lidhje me gjykimin penal përkatës, thjesht duke futur në makinën e kërkimit emrat e restorantit dhe të akuzuarit. Kërkuesi u urdhërua të paguante 5 000 Euro për secilin akuzues si kompensim për të drejtën e tyre të respektit për imazhin e tyre.

### **Ligji** - Neni 10

(a) *Konsiderata paraprake* - Kjo çështje ndryshon nga çështjet e mëparshme të Gjykatës sipas Neneve 10 dhe 8 në lidhje me përmbytjen e një publikimi në Internet (*Delfi AS kundër Estonisë* (DHM)), ose me mënyrën se si publikohet një informacion në internet, siç është anonimizimi ose kualifikimi (*M.L. Dh W.W.v. kundër Gjermanisë*). Ajo për të cilën bëhej fjalë në këtë çështje ishte kohëzgjatja dhe lehtësia e aksesit të të dhënave përkatëse dhe jo thjesht mbajtja e tyre në Internet. Në fakt, thelbi i çështjes kishte të bënte me mosheqjen nga kërkuesi, për një periudhë të gjatë dhe megjithë kërkesat formale të paditësve, nga makina e kërkimit e Internetit të të dhënave që çonin tek artikulli i publikuar prej tij.

Termat 'heqje', 'largim nga lista' dhe 'heqja e referencave', që shpesh përdoren në vend të njëra-tjetrës në burime të ndryshme të Bashkimit Europian dhe të së drejtës ndërkombëtare, tregonin veprimin e një makine kërkimi që konsistonte në largimin, me iniciativën e operatorëve të saj, nga lista e rezultateve të saj (pas një kërkimi të mbi bazën e emrit të një personi) të faqeve të Internetit të publikuar nga palë të treta që përmbajnë informacion në lidhje me atë person. Teknikisht, heqja mund të bëhet edhe nga një redaktor. Kështu, detyrimi për heqjen e materialit mund

tu ngarkohet jo vetëm ofruesve të makinës së kërkimit në Internet, por dhe administratorëve të gazetës ose arkivave gazetareske që aksesohen nëpërmjet Internetit.

*(b) Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes së kundërshtuar* - Thjesht zbatimi i kritereve të balancimit të lirisë së shprehjes dhe së drejtës së imazhit të përcaktuara në *Exel Springer AG kundër Gjermanisë* (DHM) në këtë kontest do të ishte e papërshtatshme për shkak të diferencave faktike me rastin në fjalë. Rasti i mëparshëm kishte të bënte me publikimin nga shoqëria kërkuese e artikujve të botuar që raportonin arrestimin dhe dënimin e një aktori të njohur në televizion, ndërsa rasti i tanishëm kishte të bënte me mbajtjen online, për një kohë të caktuar, të një artikulli në Internet, në lidhje me një çështje penale në ngarkim të individëve privatë.

Kështu, çështja konkrete karakterizohej nga dy tipare kryesore: (1) periudha për të cilën artikulli online kishte mbetur në Internet dhe ndikimi i tij mbi të drejtën e individit privat në fjalë për të respektuar imazhin e tij; (2) natyra e subjektit të të dhënave në fjalë, një individ privat që nuk vepron në ndonjë kontest publik dhe as si figurë politike apo publike. Në fakt, kushdo, i njohur apo i panjohur, mund të bëhen objekt i një kërkimi në internet dhe të drejtat e tij ose të saj mund të cenohen nga aksesimi i vazhduar në Internet tek të dhënat e tij ose të saj personale.

Kështu, Gjykata u kushtoi vëmendje të posaçme tre kritereve të mëposhtme.

*(i) Kohëzgjatjes gjatë së cilës artikulli ishte mbajtur online, veçanërisht në dritën e qëllimeve për të cilat të dhënat e paditësve ishin përpunuar fillimisht* - Gjykimi penal nuk kishte përfunduar akoma në momentin kur Gjykata e Lartë kishte dhënë vendimin

e saj për çështjen e kërkuesit. Megjithatë, informacioni që përmbahej në artikull nuk ishte përditësuar qysh nga ndodhia e ngjarjeve në fjalë. Për më tepër, megjithë njoftimin formal që paditësi i kishte dërguar kërkuesit duke i kërkuar heqjen e artikullit nga Interneti, ky artikull kishte mbetur online dhe ishte lehtësisht i aksesueshëm për tetë muaj. Në këtë aspekt, ligji i brendshëm dhe i zbatueshëm, i lexuar nën dritën e instrumenteve ligjore ndërkombëtare, mbështet idenë që rëndësia e së drejtës së kërkuesit për të shpërndarë informacion bie me kalimin e kohës, krahasuar kjo me të drejtën e paditësit për respektimin e imazhit të tij.

(ii) *Ndjeshmëria e të dhënave në fjalë* - Përmbajtja e artikullit në fjalë kishte të bënte me gjykimet penale të filluar ndaj një prej paditësve. Rrethanat në të cilat ishte publikuar informacioni për të dhënat sensitive përbënin një faktor që duhej të merrej parasysh gjatë balancimit të së drejtës për shpërndarjen e informacionit dhe të drejtës së subjektit të të dhënave për respektimin e jetës së tij ose të saj private.

(iii) *Ashpërsia e sanksionit të vënë* - Kërkuesit i ishte caktuar përgjegjësi sipas së drejtës civile dhe jo asaj penale. Ashpërsia e dënimit dhe shuma e kompensimit të caktuar për dënimin jo-pasuror (5 000 Euro për çdo paditës) nuk duhet të konsiderohet e tepërt, duke patur parasysh rrethanat e çështjes.

Për sa më sipër, konstatimet e juridiksionit vendas që kërkuesi kishte shkëlur të drejtën e paditësit për respektimin e imazhit të tij nëpërmjet pranisë së vazhduar në Internet të artikullit të kundërshtuar dhe nëpërmjet mosheqjes së artikullit prej tij përbënte një kufizim të justifikuar të lirisë së tij të shprehjes, aq më tepër duke patur parasysh faktin që kërkuesit nuk i ishte vendosur asnjë detyrim për ta hequr artikullin nga Interneti apo për ta anonimizuar atë.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (unanimisht).

(Shih gjithashtu *Hurbain kundër Belgjikës*, [57292/16](#), 22 qershor 2021, [Përmbledhje Ligjore](#) (kjo çështje iu kalua Dhomës së Madhe. Kjo kishte të bënte me një botues gazete, të cilit i kërkohej të anonimizonte, sipas ‘së drejtës për tu harruar’ të një shoferi i cili kishte shkaktuar një aksident fatal, versionin e arkivuar online të një artikulli të publikuar njëzet vjet më parë); *Axel Springer AG kundër Gjermanisë* [DHM], [39954/08](#), 7 shkurt 2012, [Përmbledhje Ligjore](#); *Delfi AS kundër Estonisë* [DHM], [64569/09](#), 16 qershor 2015, [Përmbledhje Ligjore](#); dhe *M.L. dhe W.W. Kundër Gjermanisë*, [60798/10](#) dhe [65599/10](#), 28 qershor 2018, [Përmbledhje Ligjore](#). Shih gjithashtu edhe vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian në *Google Spain SL dhe Google Inc.*, [C-131/12](#), 13 maj 2014, [Shënim Informativ 174](#))

## Neni 10

### Neni 10-1

#### Liria e shprehjes

Urdhrat e palegjitimuar të gjykatës ndaj një shoqërie të medias për të deklaruar të dhënat e autorëve të komenteve ofenduese të publikuar në portalin e lajmeve në internet si pjesë e një debati politik: *shkelje*

**Standard Verlagsgesellschaft GmbH kundër Austrisë (nr 3)**  
- 39378/15, Vendimi 7.12.2021 [Seksioni IV]

**Faktet** - Kërkuesi është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ka në pronësi dhe publikon një gazetë ditore të publikuar në formatin e printuar, në formatin digjital (si një 'dokument elektronik') dhe në një version online. Portali i lajmeve online përmban artikuj që i janë caktuar nga zyra editoriale dhe forumet e diskutimeve në lidhje me këto artikuj, në të cilët përdoruesit e regjistruar lejohen të postojnë komentet e tyre. Në vijim të postimit të komenteve ofenduese në dy artikuj, që shoqëria kërkuese kishte publikuar në portalin e saj në lidhje me dy politikanë dhe një parti politike, ajo u urdhërua, në dy gjykime të ndryshme në apel, për të deklaruar të dhënat e autorëve të komenteve. Gjykatat vendase refuzuan ti konsideronin këto të fundit si burime gazetarie. Shoqëria kërkuese u ankua që kjo shkelte Nenin 10 në lidhje me të drejtën e lirisë së shprehjes.

**Ligji** - Neni 10: Qysh në fillim gjykata konstatoi që çështja kishte të bënte me detyrimin e shoqërisë kërkuese si ofruese e shërbimit të deklaronte të dhënat e përdoruesve në rrethana të caktuara dhe jo përgjegjësinë e saj për komentet e përdoruesve.

(a) *Ekzistenca e një ndërhyrjeje* - Shoqëria kërkuese, në rolin e saj si redaktore e punës gazetareske, i përdorte forumet e diskutimeve në portalin e saj të lajmeve për të marrë pjesë në shpërndarjen e ideve në lidhje me temat me interes publik që mbrohen nga e drejta e shtypit. Meqenëse komentet e postuara në forum nga lexuesit e portalit të lajmeve i drejtoheshin qartazi publikut dhe jo një gazetari, ato nuk mund të konsideroheshin si burim gazetarie. Kështu, shoqëria kërkuese nuk mund të mbështetej në konfidencialitetin editorial. Megjithatë, një ndërhyrje sipas Nenit 10 mund të ndodhte edhe në mënyra të ndryshme nga ato të urdhërimit të deklarimit të burimit të gazetarisë. As edhe çështja, nëse mund të ketë ndërhyrje, nuk varej nga kategorizimi ligjor i një ofruesi shër-

bimi sipas gjykatave vendase, por në fakt nga rrethanat e çështjes në tërësi. Në rastin konkret, roli i shoqërisë kërkuese dhe aktivitetet e ndërlidhura si shoqëri e medias shtriheshin tej ofruesit të një shërbimi; ajo publikonte gjithashtu edhe një gazetë ditore dhe mirëmbante një portal lajmesh, së përbënte një forum për përdoruesit. Ajo kishte një rol aktiv në orientimin e përdoruesve për të shkruar komente, që ajo i përshkruante si një pjesë thelbësore dhe të vlefshme të portalit të lajmeve. Përmbajtja e gjeneruar nga përdoruesit në portal ishte të paktën e moderuar pjesërisht. Ishte pra e dukshme që funksioni i përgjithshëm i shoqërisë së kërkuesit ishte hapja e mëtejshme e diskutimit dhe shpërndarjes së ideve në lidhje me temat e interesit publik që mbrohen nga e drejta e shtypit. Një detyrim për deklarimin e të dhënave të autorëve të komenteve online mund ti pengonte ata në dhënien e kontributit, duke u bërë kështu shkak për një efekt ftohës tek përdoruesit që postojnë në forume në përgjithësi, dhe duke ndikuar, tërthorazi, edhe të drejtën e lirisë së shtypit për shoqërinë kërkuese.

Shoqëria kërkuese u kishte ofruar përdoruesve të saj një shkallë të caktuar anonimatit, jo vetëm për të mbrojtur lirinë e saj të shtypit, por edhe për të mbrojtur sferën private të përdoruesve dhe lirinë e shprehjes - të drejta këto që mbrohen nga Neni 8 dhe 10 i Konventës. Ky anonimat nuk do të kishte efekt, nëse shoqëria kërkuese nuk mund ta mbrojte këtë me mjetet e veta. Do të ishte e vështirë për përdoruesit ta mbronin anonimatit vetë, nëse identitetet e tyre do t'u deklaroheshin gjykatave civile. Në këtë mënyrë, ndërhyrja do të konsistonte në heqjen e anonimatit dhe efekteve të tij, pavarësisht nga rezultati i gjykimit pasues në lidhje me përmbajtjen e komenteve. Për pasojë, urdhrat e gjykatave vendase për të deklaruar të dhënat e kërkuara për përdoruesit përbënte një ndërhyrje në të drejtën e shoqërisë për të gëzuar lirinë e shtypit.

(b) *Nëse ndërhyrja është e justifikuar* - Nuk u debatua asnjëherë ndërmjet palëve që ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe që ajo i shërbente një qëllimi legjitim të mbrojtjes së imazhit dhe të drejtave të të tjerëve. Megjithatë, Gjykata konstatoi që ndërhyrja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nuk ka të drejtë absolute të anonimatit. Anonimati në Internet, megjithëse një vlerë e rëndësishme, duhej të balancohej ndaj të drejtave dhe interesave të të tjerëve. Rëndësia e balancimit të mjaftueshëm të interesave rridhte nga ky ndërgjegjësim, posaçërisht, nëse bëhej fjalë për fjalime politike dhe debate me interes publik. Kjo çështje, jo vetëm është reflektuar në praktikën gjyqësore të qëndrueshme të Gjykatës, por edhe në materialet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me ndërmjetësuesit në Internet sipas të cilave deklarimi i të dhënave të përdoruesve duhet të jetë e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. Një viktime të mundshme e një deklarimi ofendues duhet ti jepet akses i nevojshëm në gjykatë për të realizuar të drejtën e tij ose të saj para asaj gjykate. Gjykatat e brendshme, para vendim-marrjes nëse duhet të deklarohen të dhënat mbi identitetin e autorit, duhej të peshonin interesat përkatës në konflikt - në pajtim me detyrimet e tyre pozitive sipas Neneve 8 dhe 10 të Konventës. Në këtë rast, këta interesa përbëheshin nga e drejta e paditësve për të mbrojtur imazhin e tyre dhe së drejtës së shoqërisë kërkuese për lirinë e shtypit, si dhe rolin të saj në mbrojtjen e të dhënave personale të autorëve të komentit, dhe lirisë për të shprehur mendimet e tyre publikisht.

Sipas mendimit të Gjykatës, ndërhyrja e kundërshtuar në rastin konkret (detyrimi për të deklaruar të dhënat e përdoruesve) në vlerësimin sipas proporcionalitetit do të duhej të peshonte më pak se ndërhyrja në një rast kur shoqëria e medias u mbajt

përgjegjëse, sipas së drejtës civile apo penale, për përmbajtjen e një komenti të caktuar, duke u dënuar me gjobë dhe detyruar ta fshinte atë. Për pasojë, Gjykata pranoi që për ushtrimin e balancimit në gjykimet në lidhje me deklarimin e të dhënave të përdoruesit mund të mjaftonte një shqyrtim me shikim të parë, dhe gjykatat e brendshme gëzonin një marzh të caktuar diskrecioni, edhe nëse ai është i ngushtë në rastet kur bëhet fjalë për deklarimet politike. Megjithatë, edhe një shqyrtim me shikim të parë kërkon një lloj arsyesimi dhe balancimi.

Komentet e bëra në lidhje me paditësit, megjithëse tepër ofenduese, nuk ishin shndërruar në gjuhë urrejtjeje, ose nxitje për dhunë, dhe as ishin ndryshe qartazi të paligjshme. Ato ishin shprehur në kontestin e një debati publik për çështje legjitime publike, siç është sjellja e politikanëve në fjalë që veprojnë në cilësinë e tyre publike dhe komentet e tyre të publikuara në të njëjtin portal lajmesh. Meqenëse këto komente mund të karakterizohen si fjalime politike, ishte shqetësim i posaçëm që gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kishin kryer një ushtrim balancimi. Referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, e cila në fakt nuk e përjashton balancimin e interesave, ato ishin të mendimit që një balancim i tillë duhet të kryhet gjatë gjykimit në ngarkim të autorit të komenteve të ashtuquajtura ofenduese dhe jo në ngarkim të ofruesit të shërbimit përkatës. Mungesa e një balancimi të tillë kishte tejkaluar funksionin e anonimatit si mjet për shmangien e hakmarrjeve ose vëmendjes së panevojshme dhe në këtë mënyrë rolin e anonimatit në nxitjen e rrjedhës së lirë të mendimeve, ideve dhe informacionit. Për pasojë, në mungesë të balancimit të duhur, vendimet e gjykatave të apelit dhe Gjykatës së Lartë nuk mbështeteshin në shkaqe të arsyeshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen.



*Përfundimi: shkelje (unanimisht).*

Neni 41: Duke patur parasysh rrethanat e çështjes, konstatimi i një shkeljeje në vetvete përbënte një kompensim të drejtë për çdo dëm jo-pasuror që mund të ketë pësuar shoqëria kërkuese. Pretendimi për dëm financiar rrëzohet.

## II. AKTGJYKIME TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

***Anev dhe Najdovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut,***  
A. nr. 17807/15 dhe A. nr. 17893/15, Aktgjykim i datës 3 shtator  
2020

### **Neni 1 i Protokollit nr. 1, E drejta e pronësisë, gëzimit paqësor të pronësisë**

***Fakte*** – Aplikantët z.Vele Anev dhe z. Borçe Najdovski, u ankuan për shkeljen e së drejtës së tyre të pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, për faktin se në procedura të posaçme kundërvajtëse janë shpallur fajtor për kundërvajtje të kryer (për shkak të mos posedimit të dokumentacionit të duhur për masën drunore që e kanë transportuar me kamionët e tyre), në të cilat procedura përveç gjobës së shqiptuara, u janë konfiskuar edhe kamionët e tyre.

***Ankesa nr. 17807/15*** – Aplikanti Vele Anev ka qenë duke transportuar masën drunore, kur u kontrollua nga policia pyjore dhe u konstatua se të dhënat nga fletëdërgesa e bashkëngjitur nuk përputhen me damkosjen e masës drunore dhe me automjetin me të cilin e ka transportuar.

Më 16 janar 2014, Gjykata Themelore në Veles e shpalli z. Anev fajtor për kundërvajtje të kryer, të përcaktuar me nenin 104, paragrafin 1, pikën 11 të Ligjit për pyje. Me të njëjtin aktgjykim i është shqiptuar gjobë në shumë prej 3.000 euro, ndërkaq në përputhje me nenin 104 paragrafin 3 të të njëjtit ligj dhe nenin

105 të Ligjit për kundërvajtje, i cili i referohet Ligjit për procedurë penale, aplikantët i është konfiskuar kamioni dhe masa drunore.

Rrjedhimisht me këtë, ankesa e parashtruar nga aplikanti, me të cilën ai e kontestoi gjobën e shqiptuar dhe masën e konfiskimit si të kundërligjshme dhe të tepruar, iu refuzua nga Gjykata e Apelit Shkup, e cila plotësisht e konfirmoi aktgjykimin e gjykatës më të ulët.

**Ankesa nr. 17807/15** – Aplikanti Vele Anev ka qenë duke transportuar masën drunore, kur është kontrolluar nga policia pyjore dhe është konstatuar se periudha kohore brenda së cilës është bërë transporti nuk përputhet me të dhënat nga fletëdërgesa e bashkëngjitur.

Më 18 shtator 2014, Gjykata Themelore në Manastir e shpalli z. Najdovski fajtor për kundërvajtje të përcaktuar me nenin 104, paragrafin 1, pikën 11 të Ligjit për pyje. Me të njëjtin aktgjykim i është shqiptuar gjobë në shumë prej 3.000 euro, ndërkaq në përputhje me nenin 104, paragrafin 3 të të njëjtit ligj dhe nenin 41 dhe 105 të Ligjit për kundërvajtje, aplikantët i është konfiskuar kamioni dhe masa drunore.

Rrjedhimisht me këtë, ankesa e parashtruar nga aplikanti, me të cilën ai e kontestoi gjobën e shqiptuar dhe masën e konfiskimit si të kundërligjshme dhe të tepruar, iu refuzua nga Gjykata e Apelit Manastir, e cila plotësisht e konfirmoi aktgjykimin e gjykatës më të ulët.

**E drejta** – GJEDNJ-ja, gjatë vendim-marrjes për rastin konkret, ra dakord se masat e shqiptuara për konfiskimin e automjeteve (kamionëve) janë bazuar në kornizën ligjore, përkatësisht në dispozitat e Ligjit për pyje dhe Ligjit për kundërvajtje dhe në nenin 100-A të Kodit penal.

Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ra dakord se masat e shqiptuara për konfiskimin e automjeteve kishin për qëllim, përkatësisht synonin arritjen e objektivit legjitim - parandalimin e veprimeve të kundërligjshme, që është me interes publik.

Megjithatë, në rastin konkret, GJEDNJ-ja konstatoi se masat e shqiptuara ishin jo proporcionale, sepse ato u ngarkonin ankimuesve një barrë të tepërt për shkak të mungesës së një marrëdhënieje të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet masave të aplikuara nga njëra anë dhe mbrojtjes së të drejtës së pronës të ankimuesve nga ana tjetër.

GJEDNJ-ja arriti në konstatimet e theksuar të fundit duke i marrë parasysh rrethanat si vijon:

*së pari*, fakti se automjetet janë konfiskuar në kontekstin e procedurës për kundërvajtje si masa plotësuese ndaj gjobës së shqiptuar dhe konfiskimit të masës drunore të cilën e kanë transportuar aplikantët;

*së dyti*, masat për konfiskimin e automjeteve ishin të detyrueshme sipas legjislacionit vendas dhe se një konfiskim i këtillë me automatizëm, i ka privuar nga çdo mundësi për të kundërshtuar si dhe nga gjasat për sukses gjatë procedurave;

*e treta*, në rrethanat e rastit nuk kishte kurrfarë arsye për t'u frikësuar se automjetet do të përdoreshin për të kryer veprime të tjera të paligjshme;

*së katërti*, masat nuk janë shqiptuar me qëllim të sigurimit të kompensimit material për dëmin e shkaktuar, por me qëllim të pengimit dhe parandalimit të kryerjes së veprimeve të kundërligjshme;

*e pesta*, nuk u dhanë arsye bindëse pse gjoba e shqiptuar dhe masa e konfiskuar drunore, e cila është transportuar nga ap-

likantët, nuk ishin të mjaftueshme për ta arritur efektin e dëshiruar lidhur me ndalimin dhe parandalimin e kryerjes së kundërvajtjeve të ngjashme në të ardhmen;

**Konkluzion:** shkelje (unanimisht)

**Neni 41:** GJEDNJ-ja vendosi se shteti duhet t’ua kthejë ankimesve automjetet e konfiskuara, në gjendjen në të cilën ndodheshin në momentin e konfiskimit, dhe nëse një kthim i këtillë nuk është i mundur, atëherë t’i paguajë z. Anev 3.000 euro si dhe z. Najdovski 6.038 euro, në bazë të dëmit material për automjetet e konfiskuara. Gjithashtu GJEDNJ-ja aplikantët z. Najdovski i përcaktoi shumë prej 3.000 euro për dëm jomaterial. Në lidhje me shpenzimet e bëra para GJEDNJ-së, z. Anevit iu përcaktuan 769 euro, ndërsa z. Najdovski 1.500 euro.

***Gelevski kundër Maqedonisë së Veriut***, A. nr. 28032/12, Aktgjykim i datës 8 tetor 2020

### **Neni 10, Liria e shprehjes**

Ndëshkim penal për shpifje ndaj aplikantët-opinionist, meqë në një artikull gazetaresk kritikoi një gazetar

**Fakte** – Në ankesën e tij, aplikanti, një opinionist, pohonte se me ndëshkimin penal ndaj tij për shpifje, për arsye të kritikës ndaj një gazetari në një artikull të botuar gazetaresk është shkelur e drejta e tij e lirisë së shprehjes, e mbrojtur me nenin 10 të KEDNJ-së. Me fjalë të tjera, paditësi ka qenë kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i gazetës *Veçer*, ku ka botuar atikuj/opinione javore, përfshirë këtu datat 2 dhe 16 shkurt dhe datën 23 mars

të vitit 2009. Më 28 mars 2009, një grup studentësh nga Fakulteti Arkitektonik mbajtën një protestë paqësore në sheshin kryesor në Shkup. Më 31 mars 2009, aplikanti, në një tekst të botuar në shtypin ditor *Utrinski Vesnik* komentoj ngjarjet e mësipërme, duke shprehur mospajtim me politikat e Qeverisë së atëhershme, si dhe me qëndrimet e deklaruara publikisht të paditësit, duke e klasifikuar atë si mbështetës të politikave të këtilla.

Në lidhje me tekstin në fjalë të aplikantët, paditësi ka ngritur padi penale private kundër aplikantët, duke e akuzuar atë për shpifje dhe fyerje. Në periudhën përkatëse, këto vepra ishin të dënueshme sipas Kodit penal. Duke proceduar sipas kësaj padie, Gjykata Themelore Shkupi I Shkup (tani Gjykata Themelore Penale - Shkup) ka konstatuar se aplikanti është fajtor për të dyja veprat penale, duke i shqiptuar dënim monetar dhe dënim të kushtëzuar me burgim prej tridhjetë ditësh nëse aplikanti nuk e paguan gjobën e shqiptuar. Gjykata Themelore ka konstatuar se aplikanti në tekstin e tij qëllimisht ka prezantuar të pavërteta dhe pretendime të pabazuara, me ç’rast e ka cenuar nderin dhe reputacionin e paditësit dhe se në këtë mënyrë aplikanti e ka paraqitur paditësin si të pandershëm dhe jokompetent para publikut. Gjykata hodhi poshtë pretendimet e aplikantët se ai i ka komentuar pikëpamjet politike dhe sjelljen e gazetarëve të përmendur, duke përfshirë edhe paditësin, gjë që nuk duhet të interpretohet si sulm ndaj reputacionit të tyre. Aplikanti ka pohuar se artikulli i tij gazetaresk, duke përfshirë tekstin në fjalë, i përmban opinionet e tij, të cilat ishin pikëpamje vlerësuese të tij dhe jo fakte. Një argument i tillë është refuzuar nga Gjykata e Apelit Shkup, por në procedurën e shkallës së dytë, Gjykata e Apelit ka marrë vendim të pjesshëm në favor të aplikantët, me ç’rast e ka konfirmuar fajësinë e tij vetëm për veprën penale shpifje (duke përcaktuar se aplikanti nuk mund të jetë fajtor për të dyja veprat penale për

të njëjtin tekst të botuar), e ka zvogëluar dënimin monetar dhe dënimin e kushtëzuar me burgim. Së këtejmi, aplikanti ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtës së shprehjes publike deri te Gjykata Kushtetuese, e cila e ka refuzuar me vendim të datës 02.05.2012, duke konstatuar përfundimisht se argumentet e gjykatës themelore dhe të gjykatës së apelit ishin të pranueshme dhe proporcionale me qëllimin legjitim për mbrojtjen e reputacionit të të dëmtuarit (paditësit).

**E drejta** – GJEDNJ-ja e aplikoi testin e saj standard gjatë vendim-marrjes për çështjen konkrete dhe konstatoi se 1) padyshim se në këtë çështje kishte një ndërhyrje në lirinë e shprehjes së aplikantët, 2) se e njëjta ishte e ligjshme, përkatësisht në përputhje me legjislacionin vendas 3) se e njëjta kishte një qëllim legjitim - ta mbrojë reputacionin e të tjerëve 4) por vendosi se një ndërhyrje e këtillë nuk ishte në proporcion me qëllimin, dhe rrjedhimisht me këtë, nuk ka qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Me rastin e vendim-marrjes lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes në lirinë e shprehjes së aplikantët, GJEDNJ-ja si rrethanë relevante për rastin në fjalë e mori parasysh qëndrimin e aplikantët, pozicionin e paditësit, përmbajtjen e tekstit të publikuar, fjalorin e përdorur në tekst nga aplikanti dhe sanksionin e shqiptuar.

GJEDNJ-ja konstatoi se aplikanti ishte një opinionist i rregullt në një gazetë të përditshme, për këtë arsye ajo shqyrtoi ndërhyrjen në kontekstin e rolit thelbësor të shtypit të lirë në sigurimin e funksionimit të duhur të një shoqërie demokratike. Në dritën e pikëpamjeve tashmë të krijuara të GJEDNJ-së, në lidhje me paditësin, GJEDNJ-ja konstatoi se ai ishte mirë i njohur për publikun dhe se si gazetar me reputacion dhe kryeredaktor dhe redaktor

përgjegjës i një kanali televiziv dhe i një gazete ditore, ai me vetëdije i artikuloi aktivitetet e tij profesionale lidhur me monitorimin dhe në këtë kuptim opinionet e gazetarëve dhe publikut të gjerë, prandaj ai duhej të manifestojë një shkallë të lartë tolerance. Këtë GJEDNJ e konsideroi të rëndësishme veçanërisht në kontekstin e diskutimit nëse ai (paditësi) u përmbahej “de-tyrimeve dhe përgjegjësive” të gazetarit dhe kryeredaktorit dhe redaktorit përgjegjës si dhe rregullave të gazetarisë së përgjegjshme dhe etikës gazetareske. GJEDNJ-ja vlerësoi se këto aspekte janë të një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh rolin veçanërisht të rëndësishëm të medias në shoqërinë bashkëkohore, e cila nuk kufizohet vetëm në informimin e publikut, por përmes mënyrës së artikullimit të informacioneve, media njëkohësisht sugjeron se si duhet të vlerësohet nga ana e publikut. Për këtë arsye, GJEDNJ-ja konsideron se monitorimi lidhur me procedimin konform etikës gazetareske ka rëndësi shtesë.

GJEDNJ-ja konstatoi se teksti i publikuar në fjalë i përpiluar nga aplikanti nuk kishte për qëllim aktivitetet private të paditësit, por ishte shprehje e mospajtimeve të tij me politikën e Qeverisë së atëhershme, e që kontribuoi në debatin politik atëbotë aktual, i cili vetvetiu ishte me interes publik.

Gjykata, mes tjerash, ishte e mendimit se gjykatat e rregullta vendore konstatuan se teksti i publikuar i aplikantët përmban pohime/pretendime, megjithatë këtë konkluzion nuk e kanë mbështetur me fakte konkrete, e që pretendohet se janë artikuluar nga aplikanti, por nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese deklaroi se aplikantët i klasifikoi si opinione përkatësisht si gjykime të tij vlerësuese. GJEDNJ-ja konstatoi se, madje edhe nëse pranohet se teksti i publikuar përmbante fakte, ato nuk kishin të bëjnë drejtpërsëdrejti me paditësin, ndërkohë që faktet even-



tualisht të paraqitura (si p.sh. se paditësi i mbështet politikat e Qeverisë së atëhershme), nuk ishin kontestuar nga paditësi, madje as autenticiteti i tyre nuk u vlerësua nga gjykatat vendase, të cilat në thelb e kufizuan analizën e tyre sa i përket efektit të përgjithshëm të artikullit/opinionit të kontestuar në lidhje me paditësin.

Në mënyrë specifike lidhur me termin e përdorur sa u përket politikave të Qeverisë siç është termi “fashist”, GJEDNJ-ja konstatoi se artikulli i këtillë është një gjykim vlerësues dhe se nuk ishte i rëndësishëm në kontekstin e procedurës për faktin se paditësi nuk ishte anëtar i Qeverisë, përveç kësaj, aplikanti nuk ka deklaruar në tekstin kontestues se paditësi është fashist dhe se natyra shpifëse e kësaj deklarate ishte atribut i pretendimeve se paditësi ishte përkrahës i politikave të këtilla.

Lidhur me fjalorin e përdorur në tekstin e publikuar nga ana e aplikantët, Gjykata theksoi se, duke marrë parasysh se paditësi ishte një gazetar me reputacion në debatin aktual politik të asaj kohë, ndërkaq në dritën e pikëpamjeve tashmë të specifikura të Gjykatës së individëve, veçanërisht gazetarëve, të cilët marrin pjesë në një debat publik për çështje me interes të përgjithshëm, u lejohet të përdorin një nivel të caktuar provokimi dhe ekzagjerimi, në rastin konkret aplikanti nuk i ka tejkaluar kufijtë e tolerancës kritike.

Përfundimisht, Gjykata vlerësoi se ndëshkimi penal i aplikantët padyshim se mund ta kishte efektin e pengimit të debatit politik për çështje të rëndësishme midis anëtarëve të medias.

Duke marrë në konsideratë këtë që u tha më lartë, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja në fjalë në të drejtën e shprehjes së aplikantët ishte në disproporcion me objektivin dhe nuk ishte e

domosdoshme në një shoqëri demokratike, kështu që konstatoi se kishte shkelje të së drejtës së shprehjes së lirë të garantuar me nenin 10 të Konventës.

**Konkluzion:** shkelje (unanimisht)

**Neni 41:** Gjykata me aktgjykimin e saj e obligoi shtetin e aplikantët në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmëria e tij t'i paguajë aplikantët 320 euro për dëmin material dhe 3.180 euro për dëmin jo material si kompensim i drejtë lidhur me shkeljen e konstatuar.

**Memedov kundër Maqedonisë së Veriut**, A. nr. 31016/17, Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 24 qershor 2021

### **Neni 14, Ndalimi i diskriminimit**

#### **Neni 3, Ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo poshtëruës**

Shkelja e nenit 14 në lidhje me nenin 3 të Konventës për shkak të mos suksesit të autoriteteve kompetente shtetërore për të hetuar pretendimet e aplikantët në lidhje me brutalitetin policor me motive racore

**Fakte** – Në ankesën e tij, aplikanti u ankua me pretendimin për brutalitetin policor me motive racore për shkak të origjinës së tij rome dhe pretendimin sa i përket lëshimit të autoriteteve shtetërore që ta hetojnë brutalitetin policor me motive racore, duke iu referuar nenit 14 të Konventës në lidhje me nenin 3 dhe/ose nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës. Ai pohonte se trajtimi nga ana e policisë dhe lëshimi i autoriteteve shtetërore për

të kryer një hetim efektiv mbi pretendimet e tij sa i përket brutalitetet policor ish-in rezultat i “anti-ciganizmit” institucional.

Së këtejmit, më 5 maj 2013, njësi policor “Alfa” ka intervenuar në lagjen Topaana në Shkup me qëllim të privimit nga liria të personit të dënuar për sulm me thikë ndaj një personi të tretë. Sipas Qeverisë, pas privimit të personit nga liria, rreth automjetit të policisë u mbledhën një turmë e banorëve lokalë, ndërsa një pjesë e turmës tentuan ta nxjerrin nga automjeti i policisë personin e privuar nga liria. Turma përdori një vokabular fyes dhe u tregua e dhunshme ndaj punonjësve të policisë. Punonjësit e tjerë të policisë mbërritën në vendngjarje dhe urdhëruan që turma të shpërndahet, kurse ata që refuzuan i futën në dy dyqanet aty pranë. Pesë persona nga dyqanet u privuan nga liria, në mesin e të cilëve edhe aplikanti. Sipas aplikantët, disa punonjës të policisë kanë hyrë në dyqan dhe kanë filluar t’i ofendojnë dhe sulmojnë fizikisht ata që ishin brenda, duke i goditur me shkopinje gome, përfshirë edhe ankimesin, ndërkohë ai ka tentuar t’u tregojë se është pjesëtar i Armatës. Aplikanti u privua nga liria kurse në stacionin e policisë u konstatuan lëndime të dukshme në duar, qafë dhe shpinë. Të nesërmen, aplikanti u nxor para gjyqtarit hetues dhe më vonë u lëshua në liri. Sipas raporteve mjekësore të datës 7 dhe 9 maj 2013, janë konstatuar mavijosje në trupin dhe kokën e aplikantët, si dhe stres post-traumatik. Pranë GJEDNJ-së, aplikanti paraqiti fotografi me pretendimin e dëshmisë për lëndimet.

Në raportin e datës 7 maj 2013 në lidhje me përdorimin e forcës gjatë incidentit, një epror në Ministrinë e Punëve të Brendshme i konfirmoi ngjarjet që kanë pasuar menjëherë pas privimit nga liria të të dënuarit të arratisur duke specifikuar se në momentin kur arriti përforcimi, aplikanti ishte parë duke qëndruar pranë

automjetit të policisë. Edhe pse raporti konfirmoi se ishte përdorë forcë proporcionale kundër disa individëve, megjithatë raporti nuk përmbante informacione konkrete për çfarëdo lloji të forcës së përdorur ndaj aplikantët. E njëjta gjë thuhet në raportin e posaçëm të datës 12 shtator 2013 të Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili i është dorëzuar prokurorit publik të shkallës së parë në lidhje me kallëzimin penal të aplikantët.

Ministria e Punëve të Brendshme ka ngritur kallëzim penal kundër disa personave, përfshirë edhe ankimuesin, për sulm ndaj një punonjësi policie. Më 10 qershor 2013, hetimi është ndërprerë për mungesë provash të mjaftueshme se personat kanë kryer krimet për të cilat akuzoheshin.

Më 20 qershor 2013, aplikanti, ndër të tjera, përmes Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, u ankua në Sektorin e Kontrollit të Brendshëm në MPB, *mes tjerash*, për shkak të forcës së përdorur nga punonjësit e policisë në ngjarjet e 5 majit 2013. Më 5 korrik 2013, Sektori konfirmoi se forca e përdorur nga punonjësit e policisë ishte legjitime dhe proporcionale. Më 10 shtator 2013, nëpërmjet një avokati, aplikanti u ankua në Sektorin e Kontrollit të Brendshëm se ishte rrahur nga punonjësit e policisë dhe se e kanë sulmuar verbalisht, për shkak të origjinës së tij rome, dhe për rrjedhojë është diskriminuar në bazë të përkatësisë së tij etnike. Ai ka dorëzuar dokumentacion mjekësor dhe fotografi. Sektori u përgjigj se, duke pasur parasysh shqyrtimin e mëparshëm të çështjes, nuk do të bëjë hetime të mëtejme.

Në mars 2014, aplikanti, në lidhje me ngjarjet e 5 majit 2013, paraqiti një kallëzim penal kundër punonjësve të policisë (nga të cilët 6 u identifikuan) për torturë, trajtim çnjerëzor dhe poshtërues dhe diskriminim racor (të gjitha të dënueshme sipas Kodit

penal). Aplikanti ka paraqitur prova dhe ka kërkuar nga prokuroria që të hetojë punonjësit e policisë dhe personat e tjerë kundër të cilëve Ministria e Punëve të Brendshme ka ngritur kallëzime penale. Në nëntor 2014, prokurori themelor publik (PThP) e hodhi poshtë kallëzimin penal për shkak se veprat e pretenduara penale nuk ndiqeshin sipas detyrës zyrtare. Prokurori ishte i mendimit se forca e përdorur nga punonjësit e policisë ishte legjitime. Pas ankesës së paraqitur, Prokuroria e Lartë Publike (PLP) e shfuqizoi këtë vendim të Prokurorisë Themelore Publike dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, të mbahet seancë dëgjimore me ankimuesin dhe të merret parasysh se hetimi ndaj tij është ndërprerë. Për shkak të mosaktivitetit të PThP, në mars 2016, aplikanti i kërkoi nga PLP ta ndërmarrë hetimin. Kërkesa nuk u pranua.

Në mars të vitit 2017, PThP e hodhi poshtë kallëzimin penal kundër aplikantët, meqë ishte konstatuar se aplikanti ishte privuar nga liria për shkak se ka qenë pjesëmarrës i turmës, pjesëtarët e së cilës i kanë penguar punonjësit e policisë në kryerjen e detyrës. Prokurori ka mbajtur seancë dëgjimore me punonjësit e policisë ndaj të cilëve është paraqitur kallëzim penal, të cilët pohonin se ankimuesin nuk e kanë privuar nga liria. PThP konstatoi se punonjësit e policisë, të cilëve pjesëtarët e njësisë “Alfa” ua kanë dorëzuar ankimuesin, nuk kanë përdorur forcë ndaj aplikantët. Së këtejmi, prokuroria mes tjerash ka konstatuar se aplikanti në këtë ngjarje ka pësuar lëndime të dukshme, që është konstatuar edhe në dokumentacionin policor për privimin e tij nga liria. Aplikanti u ankua kundër këtij vendimi, të cilin PLP-ja e mori në konsideratë dhe urdhëroi PThP-në që të vazhdojë hetimin për të vërtetuar plotësisht faktet, veçanërisht në lidhje me rrethanat që kanë të bëjnë me privimin nga liria të aplikantët dhe përdorimin e forcës ndaj tij.

Pasi që PThP-ja mbajti seancë dëgjimore me disa punonjës policie dhe me ankimuesin, të cilët i përsëritën pretendimet nga kallëzimi penal, duke i përfshirë edhe ato për brutalitetin policor dhe pretendimin për përdorimin e gjuhës fyese nga policia, në tetor të vitit 2019 e hodhi poshtë kallëzimin penal meqë konstatoi se nuk kishte prova të mjaftueshme se të pandehurit ose ndonjë punonjës tjetër policie përdorën forcë ndaj aplikantët apo se i kanë shkaktuar vuajtje psikike për shkak të origjinës së tij rome. Për më tepër, PThP-ja konstatoi se sipas raporteve të policisë, forca e përdorur ishte legjitime dhe proporcionale dhe se hetimi nuk mund të përcaktonte me siguri se kur, si dhe ku aplikanti i kishte marrë lëndimet. Aplikanti nuk arriti të bëjë identifikimin e sulmuesve. Një vendim i këtillë në janar të vitit 2020 u konfirmua nga PLP.

Ankuesi në vitin 2016 ngriti padi civile kundër MPB-së për kompensim të dëmit për shkak të diskriminimit me pretendimin se ai ishte subjekt i dhunës policore me motive etnike, të cilën Gjykata Themelore Shkup në dhjetor të vitit 2018 e hodhi poshtë dhe pasi që e mbajti seancën dëgjimore me disa nga punonjësit e policisë, me dëshmitarët (me njërin nga të pandehurit, me ankimuesin dhe babanë e aplikantët si dëshmitar okular të ngjarjeve) ndërkohë bëri një këqyrje mbi videoregjistrimet e dyqanit, të cilat ishin publikisht të aksesshme, ndërkaq në pamundësi që të sigurojë të tjera nga MPB, nga të cilat nuk kishte mundësi të konstatojë nëse personi në këto videoregjistrime të dyqanit është aplikanti, si prova i ka nxjerrë raportet ndërkombëtare mbi gjendjen e romëve në vend, ka konstatuar se nuk kishte prova të mjaftueshme se punonjësit e policisë e kanë diskriminuar ankimuesin në bazë të origjinës së tij rome, edhe pse, gjykata e shkallës së parë, i vlerësoi si autentike përkatësisht si të besueshme pretendimet e aplikantët se gjatë qëndrimit të tij në

dyqan punonjësit e policisë e kishin goditur. Ai konstatoi se aksioni i policisë ndodhi në një vendbanim me popullatë dominante rome, që shpjegon faktin se të privuarit nga liria ishin romë, por se policia nuk ishte selektive dhe privoi të gjithë personat nga liria, ndërkaq dëshmitë lidhur me përdorimin e gjuhës fyese i ka vlerësuar si arbitrare dhe jokonzistente me provat e tjera. Një vendim i këtillë u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit Shkup.

Aplikanti mes tjerash ngriti një padi për diskriminim kundër prokurorisë për mos hetimin e pretendimeve për brutalitetin policor. Padia u hodh poshtë nga Gjykata Themelore Shkup, dhe u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit. Aplikanti i kontestoi këto vendime në Gjykatën Kushtetuese me kërkesën që të konstatojë diskriminim nga ana e prokurorisë për shkak të origjinës së tij rome. Procedura para Gjykatës Kushtetuese akoma është në rrjedhë e sipër.

***E drejta*** – GJEDNJ-ja vlerësoi se krahas pohimit të vazhdueshëm të aplikantët se ai ishte fyer nga punonjësit e policisë në lidhje me origjinën e tij rome, pretendimet e këtilla nuk u hetuan tërësisht nga prokuroria, hetimi i së cilës u fokusua në përdorimin e forcës nga punonjësit e policisë, pa i marrë parasysh në mënyrë të duhur motivet e mundshme racore për një sjellje të tillë, të cilat ishin të dënueshme sipas legjislacionit vendor. Gjykata konstatoi se prokuroria nuk ka mbajtur seancë dëgjimore me dëshmitarët e propozuar nga aplikanti, me dëshmitarët që ndodheshin në dyqan, të cilët mund të jepnin informacione të drejtpërdrejta për ngjarjen e diskutueshme ndërsa prokuroria nuk dha sqarime për këtë mosveprim. Nga ana tjetër, në procedurën civile kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjykata vendase ka mbajtur seancë dëgjimore me dëshmitarët okularë, të cilët i konfirmuan pretendimet e aplikantët, por gjykata civile i

ka konsideruar të njëanshme dhe nuk i ka marrë parasysh. Sipas Gjykatës, asgjë nuk e vë në dukje atë se deklaratat e dëshmitarëve dhe gjetjet e gjykatës civile kanë luajtur ndonjë rol në vendimin përfundimtar të prokurorisë, i cili është marrë pas procedurës civile kundër MPB-së. Përveç kësaj, Gjykata vlerësoi se nuk ishte dhënë asnjë sqarim në lidhje me pretendimet për fyerje racore, të cilat aplikanti vazhdimisht i ka ngrit para prokurorisë. Prokuroria, në mënyrë të përmbledhur konstatoi se nuk kishte prova të mjaftueshme apo se ndonjë punonjës tjetër i policisë, të pandehurit i kanë shkaktuar vuajtje psikike në lidhje me origjinën e tij rome.

Bazuar në këto pretendime, Gjykata konstatoi se prokuroria nuk veproi në përputhje me detyrimin e saj nga nenin 14 i Konventës në lidhje me nenin 3, për t'ji ndërmarrë të gjitha hapat e mundshme për të përcaktuar nëse qëndrimet diskriminuese, madje mund të kenë luajtur ndonjë rol në veprimet e punonjësve të policisë në ngjarjen kontestuese. Për rrjedhojë, ajo konstatoi shkelje të nenit 14 të Konventës në lidhje me aspektin procedural të nenit 3.

Gjykata i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e aplikantët për brutalitetin policor me motive racore, përkatësisht pretendimet për shkelje të nenit 14, në lidhje me nenin 3, në aspektin e tij material, sepse nuk kishte argumente të mjaftueshme që Gjykata të konstatojë se kishte keqtrajtim policor për shkak të përkatësisë racore, përkatësisht keqtrajtim racist.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e aplikantët për diskriminim në lidhje me nenin 14 të Konventës, duke pasur parasysh se kuptimi i termit “diskriminim” në dritën e nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës është identik me kuptimin që ka ky term konform nenit 14 të Konventës. Nga ana tjetër, gjykata nuk i shqyrtoi veçmas pretendimet e aplikantët për shkelje të nenit 1 të Protokollit



nr. 12 të Konventës dhe/ose nenit 14 në lidhje me nenin 6 të Konventës, të artikuluar para Gjykatës gjatë procedurës kundër shtetit, në lidhje me faktin se gjykatat civile nuk e kanë zbatuar në mënyrë përkatëse standardin sa i përket barrës së provës, duke i vlerësuar pretendimet e këtilla si të lidhura ngushtë dhe të absorbuara me pretendimet që kanë të bëjnë me nenin 14 në lidhje me nenin 3 të Konventës.

**Konkluzion:** shkelje (unanimisht)

**Neni 41:** Gjykata me aktgjykimin e saj e obligoi shtetin që në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmëria e tij aplikantët t’i paguajë 3.000 euro për dëm jomaterial si kompensim i drejtë për shkeljen e konstatuar.

***Kostova dhe Apostolov kundër Maqedonisë së Veriut***, A. nr. 38549/16, Aktgjykim i datës 5 prill 2022

### **Neni 10, Liria e shprehjes**

Vendimet e gjykatave vendase kundër ankimesve janë ndërhyrje të pajustificuara në realizimin e së drejtës së tyre të lirisë së shprehjes sipas nenit 10

**Fakte** – Rasti konkret i referohet dy teksteve të publikuara nga gazeta e përditshme “Fokus” në të cilat aplikantët ishin gazetarë, ndërsa ankimesja e parë njëkohësisht ishte kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse e gazetës. Në tekstet citonin ose përdornin gjuhë indirekte për të përcjellë informacione të cilat z. I. ua ka dërguar përmes postës elektronike dhe në formën e një deklaratë të nënshkruar me shkrim, se z. S., drejtor i atëhershëm i

Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë dhe Kundërzbulimit dhe një anëtar i lartë i partisë në pushtet në atë kohë, ka ushtruar presion mbi titullarët e tjerë të funksioneve publike që të mos ndërhyjnë në zgjidhjen e një çështjeje personale të z. I. ish-ambasador i shtetit në Çeki, i cili ishte ambasador në kohën e ngjarjeve të cilat e kanë prekur jetën e tij private. Veç kësaj, në njërin nga tekstet përmendet se “jozyrtarisht” z. S. zotëron një “perandori biznesi në Çeki”, ndërsa para publikimit të teksteve kontestuese, njëri nga aplikantët pa sukses u përpoq të merrte një përgjigje nga z. S.

Në procedurën civile për shpifje të ngritur nga z. S., Gjykata Themelore Shkup dhe Gjykata e Apelit konstatuan se aplikantët e kanë dëmtuar reputacionin e drejtorit të atëhershëm duke publikuar fakte të pavërteta që i kanë cilësuar si “thashetheme”, pa bërë përpjekje paraprake ta konfirmojnë autenticitetin e tyre; se informacionet e publikuara nuk i shërbenin interesit publik dhe se jeta personale e z. I. në mënyrë të pabazë lidhej me funksionin publik të z. S. Rrjedhimisht, edhe Gjykata Kushtetuese i konfirmoi qëndrimet e tilla të gjykatave të rregullta.

**E drejta** – Me rastin e shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, Gjykata konfirmoi se:

- përmbajtja e teksteve edhe pse në të vërtetë kishte të bëjë me jetën personale të z. I., megjithatë ka prekur edhe çështje me interes publik që mund të kontribuojnë në debatin publik (presion i pretenduar i një titullari të funksionit publik ndaj titullarëve të tjerë të funksioneve publike dhe në këtë kuptim pretendime për shpërdorim të pushtetit nga një funksionar i lartë publik në lidhje me çështje të natyrës personale të z. I.);
- tekstet e kontestuara përmbanin fakte, por që gjykatat ven-

dase, kur i cilësuan ato si thashetheme, nuk e morën parasysh *së pari*, se ato burimin nuk e kishin nga aplikantët të cilët vetëm raportnin për informacionet që i pranuan me shkrim nga z. I., *së dyti*, se kjo qartë ka rezultuar nga fakti se aplikantët kanë përdorur citate ose gjuhë indirekte, dhe se në fund aplikantët kanë bërë përpjekje për të konfirmuar informacionet dhe për të konfirmuar të vërtetën para publikimit përmes zëdhënësit zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme, me ç'rast ata vepruan me kujdes si gazetarë të përgjegjshëm, të cilët në dritën e tentativës së pasuksesshme për t'i verifikuar pretendimet e z. I. të cilat i publikuan, nuk mund të llogariten si të përgjegjshëm meqë nuk patën sukses ta verifikojnë autenticitetin e pohimeve/pretendimeve kontestuese;

- pretendimet për “perandorinë e biznesit” të z. S. në tekstet ishin paraqitur qartazi se vinin nga një burim anonim dhe se kishin për qëllim të hedhin dritë mbi marrëdhëniet e biznesit të z. S. me Republikën Çeke;
- nuk është dëshmuar se ndonjë aspekt i reputacionit dhe nderit të z. S. ishte seriozisht i cenuar nga tekstet e kontestuarra, por gjithashtu se çdo interes i mundshëm që ai mund të kishte për të mbrojtur reputacionin e tij ishte mjaftueshëm i mbrojtur nga mundësia e inicimit të procedurës për përgjegjësi civile për shpifje;
- shumica e dëmshtëpërblimit të përcaktuar nga gjykatat vendase në procedurën civile e cila në mënyrë të padiskutueshme disa fish e tejkalon shumën e pagës minimale në periudhën kontestuese në shtet (5.000 euro për njërin ankimues dhe 1.000 euro për ankimuesin tjetër), edhe pse me sa duket ankimuesve nuk ua paguan, kishin “efekt të zmbropsjes” i cili e dekurajon debatin transparent në temat me interes publik;

- përfundimisht, në dritën e asaj që u tha më lart, gjykatat vendase me vendimet e tyre nuk siguruan një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti sa i përket cenimit të pretenduar të reputacionit të z. S.

**Konkluzion:** shkelje (unanimisht)

**Neni 41:** Gjykata e obligoi shtetin që në afat prej 3 muajsh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit ankimuesve t'u paguajë një shumë prej 4.250 euro si vijon: një shumë të përgjithshme prej 3.000 euro si dëm jomaterial, përkatësisht veç e veç për secilin ankimues ndividualisht nga 1.500 euro dhe një shumë të përgjithshme prej 1.250 euro si kompensim i përbashkët për shpenzimet, më së voni deri më datë 27 qershor 2022.

**A.A. dhe të Tjerë kundër Maqedonisë së Veriut** - 55798/16, 55808/16, 55817/16 et al. Vendimi 5.4.2022 (Seksioni II)

#### **Neni 4 i Protokollit Nr. 4**

##### **Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve**

Mungesa e vendimeve individuale të dëbimit për emigrantët që mbërrijnë në grupe të mëdhenj dhe që shmangin procedurat e rregullta dhe efektive ligjore të hyrjes pa shkaqe bindëse: nuk ka shkelje

**Faktet** – Kërkuesit, shtetas afganë, irakenë dhe sirianë u larguan nga vendi i tyre i origjinës dhe mbërritën në Greqi. Në mars të vitit 2016, kërkuesit kaluan kufirin dhe hynë në territorin maqedonas, duke iu bashkuar grupeve të mëdhenj të refugjatëve dhe ecur përmes një lumi në atë që u bë i ditur si 'Marshimi i

Shpresës'. Menjëherë pas kësaj, ata u zbuluan nga ushtarët, të cilët pretendohet ti kenë kërcënuar ose përdorur dhunë dhe i urdhëruan ata të kthehen në Greqi. Ata e ri-kaluan kufirin për në Greqi më këmbë.

**Ligji** – Neni 4 i Protokollit Nr. 4: Emigrantët u larguan nga Shteti i paditur pa iu nënshtruar ndonjë procedure identifikimi apo shqyrtimi i situatës së tyre personale nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut. Nga kjo mund të nxirret përfundimi që përzënia e tyre ishte e një natyre kolektive, përveç nëse mos-shqyrtimi i situatës së tyre mund të jetë për shkak të sjelljes së tyre. Kështu Gjykata vazhdoi me shqyrtimin nëse mungesa e vendimeve individuale të dëbimit mund të justifikohet nga sjellja e vetë kërkuesve.

Kërkuesit ishin pjesë e dy grupeve të mëdhenj emigrantësh, të cilët kishin kaluar kufirin e Shtetit të paditur në një mënyrë të paautorizuar. Megjithatë, nuk kishte asnjë tregues që kërkuesit, ose njerëz të tjerë në grup, të kishin përdorur ndonjë forcë apo u kishin rezistuar nëpunësve. Kështu, edhe nëse kjo çështje mund të krahasohet me rrethanat e çështjes N.D., dhe N.T., kundër Spanjës, në këtë rast nuk ishte përdorur asnjë forcë.

Gjykata, megjithatë, shqyrtoi nëse, duke e kaluar kufirin ilegalisht, kërkuesit kishin anashkaluar procedurën efektive të hyrjes së ligjshme.

E drejta maqedonase u kishte ofruar kërkuesve një mundësi hyrjeje në territorin e Shtetit kërkues në pikat e kalimit kufitar, nëse ata do të përmbushnin kriteret e hyrjes ose, nëse nuk i përmbushnin, nëse ata do të kishin kërkuar azil ose të paktën të deklararin se ata kishin ndërmend të kërkonin azil. Kjo kërkonte shqyrtimin e rrethanave individuale për secilin kërkues dhe një vendim dë-

bimi, nëse këtë do ta kërkonin rrethanat, ku ky vendim mund të ishte ankimuar. Shteti i paditur kishte dhënë informacion specifik se sa vërtetime ishin lëshuar në lidhje me synimin e shprehur për të aplikuar për azil, dhe sa kërkesa për azil ishin paraqitur, si dhe informacion specifik në lidhje me kalimin më të afërt të kufirit, infrastrukturën përkatëse atje, organizatat e ndryshme të pranishme në vend dhe informacionin që tregonte se synimet për të aplikuar për azil ishin shprehur shprehimisht në të:

- afërsisht 500 000 vërtetime për synimin e shprehur për të aplikuar për azil ishin lëshuar ndërmjet 19 qershorit 2015 dhe 8 marsit 2016, nga të cilat një shumicë e konsiderueshme u ishin lëshuar të njëjtave shtetësi si dhe atyre të kërkuësve në rastin konkret.
- kalimi më i afërt i kufirit për në kamp, pika e kalimit kufitar Bogorodica, ishte një nga pikat më intensive të kalimit të kufirit, ku ishin lëshuar më shumë se 300 000 vërtetime deri në fund të dhjetorit të vitit 2015.
- ndërsa nuk kishte informacion specifik në lidhje me disponibilitetin e përkthyesve, ishte e qartë që kishte patur një lloj shërbimi përkthimi.

Pra nuk ka patur vetëm një detyrim ligjor për të pranuar kërkesat për azil dhe synimet e shprehura për të aplikuar për azil në pikat e kalimit kufitar, por edhe një mundësi reale për ta bërë këtë.

Kërkuësit kishin parashtuar se për ta nuk ishte e mundur të kërkonin azil në pikën e kalimit kufitar në Bogorodica në momentin e dëbimit të tyre masiv, që ishte në ose rreth datës 14 dhe 15 mars 2016, pasi të dhënat përkatëse kishin konfirmuar që në atë kohë nuk ishte lëshuar asnjë certifikatë në lidhje me synimin e shprehur për të aplikuar për azil. Gjykata vuri re që më 8

mars 2016, transiti nuk kishte qenë efektivit i mundur për shkak të qëndrimit të ndryshëm nga Bashkimi Europian në lidhje me numrin në rritje të emigrantëve dhe reagimit pasues të vendeve gjatë itinerarit të Ballkanit. Megjithatë, asgjë nuk tregonte që nuk ka qenë e mundur të kërkohej azil në pikën e kalimit kufitar.

Nuk kishte asnjë të tregonte që azil-kërkuesit e mundshëm ishin penguar në një mënyrë të caktuar për t'iu afruar pikave legjitime të kalimit kufitar dhe të paraqisnin pretendimin e tyre për azil ose që kërkuesit të ishin përpjekur të kërkonin azil në pikën e kalimit kufitar dhe ata ishin kthyer mbrapsht. Kërkuesit në rastin konkret as nuk pretenduan që ata ishin përpjekur të futeshin në territorin maqedonas me mjete të ligjshme. Kështu, Gjykata nuk është e mundur që ata kishin shkaqet e arsyeshme të kërkua për të mos përdorur pikën e kalimit kufitar Bogorodica apo një pikë tjetër në momentin përkatës, me synim paraqitjen e shkaqeve kundër dëbimit të tyre në një mënyrë të arsyeshme dhe të ligjshme. Kjo tregonte se ata nuk ishin të interesuar të aplikonin për azil në Shtetin e paditur, por ishin të interesuar të kalonin transit në të, që nuk ishte më e mundur dhe, për pasojë, ata kishin zgjedhur ta kalonin atë ilegalisht.

Për këto arsye, megjithë disa mangësi në procedurën e azilit dhe përzëniet e raportuara, Gjykata nuk u bind që Shteti kishte dështuar në ofrimin e aksesit të vërtetë dhe efektiv në procedurat për hyrjen e ligjshme në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht duke ofruar mbrojtjen ndërkombëtare në pikat e kalimit kufitar, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen sipas Nenit 3 ose që kërkuesit kishin shkaqe të arsyeshme, për të cilat Shteti i paditur ishte përgjegjës, për të mos i përdorur këto procedura.

Në fakt ishin kërkuesit që e kishin vënë veten e tyre në rrezik duke marrë pjesë në hyrjen e paligjshme në territorin maqed-

donas, duke përfituar nga numri i madh i grupit. Mungesa e vendimeve individuale të dëbimit ishte pasojë e sjelljes së tyre.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (unanimisht).

Gjykata gjithashtu ishte unanimisht e mendimit që nuk kishte patur shkelje të Nenit 13, i marrë në lidhje me Nenin 4 të Protokollit nr 4, në lidhje me disponibilitetin e një mbrojtjeje efektive me efekt pezullues nëpërmjet të cilit të kundërshtohet dëbimi masiv. E drejta maqedonase e ofronte mundësinë e ankimit ndaj urdhrave të dëbimit. Megjithatë, nëpërmjet përpjekjes së futjes në territor si një pjesë e një grupi të madh dhe në një vend të paautorizuar, kërkuesit e kishin vënë veten e tyre në një situatë të paligjshme dhe në këtë mënyrë kishin zgjedhur të mos përdornin procedurat e ligjshme që kishin ekzistuar.

(Shih N.D. dhe *N.T. kundër*

*Spanjës* [DHM], [8675/15](#) dhe [8697/15](#), 13 shkurt

2020, [Përmbledhje Ligjore](#); shih gjithashtu *Shahzad kundër*

*Hungarisë*, [12625/17](#), 8 korrik 2021, [Përmbledhje Ligjore](#),

dhe *M.H. dhe të tjerë kundër Kroacisë*, [15670/18](#) dhe [43115/18](#),

18 nëntor 2021, [Përmbledhje Ligjore](#))

***Kostovski kundër Maqedonisë së Veriut***, A. nr. 23773/17, Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 7 qershor 2022

### **Neni 6 paragrafi 1 – E drejta për procedurë të drejtë (procedura penale)**

Autoritetet vendase nuk dhanë arsyetimin e duhur për refuzimin e kërkesës së aplikantët për të mbajtur një seancë gojore dhe për t'i pranuar video-regjistrimet si prova



**Fakte** – Aplikanti në ankesën e tij u ankua se në procedurën për kundërvajtje kundër tij nuk është mbajtur seancë gojore dhe se autoritetet vendase refuzuan t’i pranojnë provat, që është në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 6 paragrafin 1 të GJEDNJ-së. Aplikanti mes tjerash u ankua edhe për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, duke pohuar se masat e shqiptuara në procedurën për kundërvajtje ishin të tepruara.

Më 15 tetor të vitit 2014, aplikanti, duke udhëtuar me automobil bashkë me djalin e tij, është ndaluar nga doganierët në pikën e kalimit kufitar të shtetit me Republikën e Serbisë. Pas kontrollit të bërë ndaj aplikantët punonjësit e doganës gjetën 11.100 euro të cilat aplikanti nuk ua kishte deklaruar punonjësve të doganës, me ç’rast, konform dispozitave ligjore, atij i janë kthyer 2.000 euro, ndërsa pjesa tjetër i është sekuestruar. Për ngjarjen është përpiluar procesverbal, të cilin aplikanti e ka nënshkruar. Aplikanti dorëzoi edhe deklaratën e tij me versionin e tij të ngjarjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ngriti procedurë kundërvajtëse kundër aplikantët për tentativë për nxjerrje jashtë shtetit të valutës pa e deklaruar. Më 29 tetor të vitit 2014, aplikanti dorëzoi përgjigje në të cilën pohon se e ka deklaruar valutën e huaj dhe në cilësinë e provës, ndër të tjera ka paraqitur vërtetim nga një këmbimore, ku ka kërkuar mbajtjen e seancës gojore, si dhe sigurimin e videoregjistrimeve nga kamerat e kalimit kufitar si provë. Autoriteti doganor nuk iu përgjigj kërkesës së tij.

Në mars të vitit 2015, autoriteti doganor konstatoi se aplikanti ka kryer kundërvajtje, dhe vendosi sekuestrim të përkohshëm të mjeteve (9.100 euro) dhe i shqiptoi gjobë në lartësi prej 1.500 euro.

Aplikanti ka iniciuar kontest administrativ duke u ankuar për mungesën e seancës gojore dhe mosmarrjen parasysh të kërkesës së tij për sigurimin e video-regjistrimeve nga kamerat në pikën e kalimit kufitar si provë. Gjykata Administrative e anuloi vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, por nuk i shqyrtoi kërkesat e aplikantët të datës 29 tetor 2014. Në vitin 2016, Gjykata e Lartë Administrative, me aktgjykim të formës së prerë e hodhi poshtë kërkesë-padinë e aplikantët, duke i përfshirë edhe pretendimet e ankesës së aplikantët për mosmbajtjen e seancës gojore në Gjykatën Administrative, duke konstatuar se çështja nuk ishte komplekse dhe nuk ishte e nevojshme të mbahet seancë gojore për përcaktimin e gjendjes faktike. Ajo konstatoi se aplikanti është dashur t'i deklarojë mjetet valutore tek organet doganore kurse vërtetimin e këmbimores t'ua tregojë gjatë kalimit të kufirit. Lidhur me kërkesën për sigurimin e video-regjistrimeve në cilësinë e provave, Gjykata e Lartë Administrative vetëm konstatoi se një kërkesë e tillë është e pabazuar, ndërkaq në vendimin e saj nuk iu referua pretendimeve se autoriteti doganor nuk e kishte marrë parasysh ankesën e aplikantët të datës 29 tetor 2014.

**E drejta** – GJEDNJ-ja gjatë vendim-marrjes së saj ishte e mendimit se autoritetet vendase nuk e morën parasysh kërkesën e aplikantët për të zhvilluar një seancë gojore, me përjashtim të Gjykatës së Lartë Administrative në vendimin e formës së prerë kundër të cilit aplikanti nuk mund të paraqesë ankesë. Gjykata konsideronte edhe pse rrethanat e çështjes nuk ishin veçanërisht komplekse, fakti se procesverbali nuk përmbante informacione se ku u gjet valuta e huaj, pamundësia e aplikantët për t'u parashtruar pyetje punonjësve doganorë me të cilët nuk është mbajtur seancë dëgjimore në asnjë fazë të procesit gjyqësor vendor dhe fakti që gjoba dhe mjetet e sekuestruara valutore ishin barrë për ankimesin prej 10.500 euro janë argumente të mjaftueshme

për të mbajtur seancë gojore për përcaktimin e drejtë të gjendjes faktike të çështjes, veçanërisht për shkak se aplikanti në ankesën e tij ka pohuar se i ka deklaruar mjetet valutore. Mes tjerash, Gjykata vuri në dukje se autoritetet vendase nuk i trajtuan në mënyrë adekuate argumentet e aplikantët lidhur me kërkesën për të mbajtur një seancë gojore, ndërkaq GJEDNJ-ja konstatoi se një gjë e këtillë ishte e nevojshme në rrethanat e çështjes.

Lidhur me kërkesën e aplikantët për shqyrtimin e video-regjistrimeve nga vendkalimi kufitar si provë, Gjykata vuri në dukje se asnjë nga autoritetet vendase që vepruan në procedurën kontestuese nuk ishin prononcuar për të njëjtën gjë. Gjykata e shqyrtoi argumentin e Qeverisë të paraqitur në procedurë para Gjykatës, se videoregjistrimet nuk kishin zërim dhe se aplikantët iu dha mundësia të bënte një deklaratë me shkrim dhe t'i kontestojë provat kundër tij, megjithatë konstatoi se të njëjtat nuk mund të merren parasysh për shkak se arsyet e këtilla nuk janë potencuar nga autoritetet vendase gjatë vendim-marrjes së tyre, ndërkaq të njëjtat duhet t'i justifikojnë në vendimet e tyre.

Sipas asaj që u konstatua, Gjykata gjeti se në çështjen në fjalë autoritetet vendase nuk dhanë justifikimin e duhur për refuzimin e kërkesës së aplikantët për të mbajtur një seancë gojore dhe për të pranuar video regjistrimet si prova, për shkak të së cilës ekziston shkelje e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 paragrafin1 të Konventës.

**Konkluzion:** shkelje (unanimisht)

**Neni 41:** Për shkeljen e konstatuar, Gjykata e obligoi shtetin e aplikantët t'i paguajë 3.600 euro për kompensim të dëmit jomaterial dhe 850 euro për kompensim të shpenzimeve në kundërvlerë në denarë.

***Talevska dhe Tërçevska kundër Maqedonisë së Veriut***, A. nr. 11828/16, Aktgjykim i GJEDNJ-së i datës 28 qershor 2022

### **Neni 6 paragrafi 1 – E drejta për procedurë të drejtë (procedura civile)**

Mos dërgimi i njoftimit të Këshillit Gjyqësor të datës 13.03.2013 deri te ankimueset

**Fakte** – Çështja i referohet pretendimeve ankimore në lidhje me shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë për faktin se në procedurën civile në të cilën ankimueset ishin paditëse, ato janë privuar nga mundësia për t’u njoftuar nga gjykatat vendase dhe gjatë procedurës të bëjnë komente në lidhje me njoftimin e datës 13 mars 2013 të paraqitur nga ana e të paditurit, ankimueset gjithashtu parashtruan pretendime ankimore për mungesën e seancës gojore në procedurën para Gjykatës së Apelit dhe se Gjykata Supreme nuk ka artikuluar arsye të mjaftueshme për vendimin e saj, veçanërisht për lëshimin e Gjykatës së Apelit që t’ua dërgojë ankimueseve njoftimin në fjalë të datës 13 mars 2013. Ankimueset mes tjerash artikuluan edhe pretendime për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili e garanton të drejtën e pronës.

Me fjalë të tjera, ankimueset janë paraqitur në Agjencinë për Punësim, në bazë të aktvendimeve për punësim në Gjykatën Themelore Ohër, për një afat të pacaktuar, të cilat ishin nënshkruar nga ushtruesi i detyrës së atëhershme Kryetar i Gjykatës. Megjithatë, disa ditë pas evidentimit dhe paraqitjes në Agjencinë e Punësimit, nga ana e u.d. Kryetarit të Gjykatës Themelore Ohër një kërkesë i është dërguar Qendrës për Punësim në Ohër për shlyerjen e ankimueseve nga evidenca e të punësuarve, me ç’rast fletëparaqitjet e tyre pranë Agjencisë së Punësimit u janë

pezulluar, ndërsa janë shlyer edhe nga evidenca e sigurimit të detyrueshme social.

Pas disa përsëritjeve të procedurës, Gjykata e Apelit Manastir me vendim të datës 12 shkurt 2015, e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e ankimueseve. Së këtejmi, e mori në konsideratë ankesën e të paditurit në bazë të parashtresës së tij-njoftim i datës 13 mars 2013, në të cilin Këshilli Gjyqësor pohon se “kryetari i një gjykate mund të legjitimohet dhe të prezantohet në qarkullimin juridik që nga momenti i lëshimit të aktvendimit nga Regjistrin Qendror për regjistrimin e kryer në bazë të vendimit të Këshillit Gjyqësor për zgjedhjen e kryer”. Kështu që Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se në kohën kur u.d. kryetari, të paditurit ia nënshkroi aktvendimet për punësim, procedura për emërimin dhe regjistrimin e tij në Regjistrin Qendror (në tekstin e mëtejshëm: RQ) nuk është kryer, që do të thotë se aktvendimet e punësimit kanë qenë pa efekt juridik dhe për rrjedhojë nuk ka pasur bazë ligjore që ankimueset të paraqiten në Agjencinë e Punësimit dhe në sigurimin e detyrueshëm social. Pretendimet e Qeverisë se parashtresa e kontestuar, përkatësisht njoftimi, nuk ishin të një rëndësie kryesore gjatë procedurës, GJEDNJ-ja i hodhi poshtë si të pabazuara sepse kishte konstatuar se Gjykata e Apelit njoftimin e kontestuar e trajtoi si njoftim kryesor, e cila për herë të parë në mënyrë plotësuese specifikon se kompetencat e ushtruesit të detyrës kryetarit fillojnë nga dita e regjistrimit në Regjistrin Qendror, aq më tepër që ky njoftim ishte në kundërshtim me njoftimin e të njëjtit autoritet të datës 10 janar 2013, të dorëzuar paraprakisht në të njëjtën procedurë, sipas të cilit u.d. kryetari kishte autorizim për t’i nënshkruar aktet e punësimit nga dita e emërimit të tij. Në kushte të këtilla, GJEDNJ-ja ka marrë parasysh edhe atë se Gjykata Supreme mbeti pa fjalë sa u përket preten-

dimeve të ankimueseve, gjatë vendim-marrjes së kërkesës për re-vizion është e pabazuar, në lidhje me mos dërgimin e njoftimit kontestues të datës 13 mars 2013.

***E drejta*** Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, Gjykata konsideron se duke mos e dërguar njoftimin e Këshillit Gjyqësor të datës 13 mars 2013 deri te ankimueset, ankimueset janë privuar nga e drejta për një procedurë të drejtë. Nga kjo rezulton se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafit 1 të Konventës.

Lidhur me pretendimet e tjera ankimore të ankimueseve të theksuara në ankesën konform nenit 6 paragrafit 1 të Konventës për mungesë të seancës gojore në Gjykatën e Apelit dhe mungesën e pretenduar të justifikimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, si dhe në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, ndërkaq në dritën e shkeljes tani më të konstatuar, Gjykata konsideron se nuk e sheh të nevojshme të miratojë vendim të veçantë për pretendimet e tjera ankimore.

***Konkluzion:*** shkelje (unanimisht)

**Neni 41:** Për shkeljen e konstatuar, Gjykata e obligoi shtetin në afat prej 3 muajsh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, ankimueseve t’ua paguajë shumën e përgjithshme prej 4.850 euro në kundërvlerë në denarë, si vijon: nga 1.500 euro secilës ankimuese për kompensimin e dëmit jomaterial dhe një shumë prej gjithsej 1.850 euro të dyja ankimueseve për kompensimin e shpenzimeve.